



MINISTRIA E DREJTËSISË

VJETARI STATISTIKOR 2008

Tiranë, 2008

Botim i Ministrisë së Drejtësisë

Zyra e Statistikës dhe Bibliografisë

Drejtoria e Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë

Viti i shtatë i botimit

Punoi: **Matilda Hoxha** – Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit Administrativ

Asistoi: **Eljona Bylykbashi** - Specialiste në Drejtorinë e Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë

Blerina Kajushi - Specialiste në Drejtorinë e Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë

Manjola Kelolli – Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor

Jonida Dervishi – Specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit

Eriketa Korini – Specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit

LËNDA

Fjala e Ministrit të Drejtësisë	5
Hyrja	7
KREU I	
Statistika për çështjet penale dhe civile të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë	13
Statistika për çështjet penale dhe civile të regjistruara nga gjykatat e shkallës së parë	14
Statistika për çështjet penale dhe civile të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë	16
Statistika për çështjet penale dhe civile të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë në përqindje sipas periudhave	18
Dinamika e çështjeve penale	19
Mënyra e përfundimit të çështjeve penale	20
Çështjet penale sipas rretheve	21
Ndarja e çështjeve penale në krime & kundërvajtje penale të gjykuara	22
Çështje penale gjithsej të gjykuara	23
Seria dinamike e kërkesave penale sipas gjykatave të rretheve	25
Shpejtësia e gjyimit	27
Volumi i punës për vitet e fundit për çështjet penale	28
Krahasimi i dinamikës së çështjeve penale për vitet e fundit	29
KREU II	
Klasifikimi i çështjeve penale dhe ankimimet	33
Seritë dinamike që tregojnë ankimet në gjykatat e shkallës së parë	36
Apelimet	37
Rekurse të drejtpërdrejta	38
Çështje të gjykuara, krimet	39
Kundërvajtjet	47
Mënyra e përfundimit të çështjeve penale me vendime gjyqësore përfundimtare	51
Klasifikimi i të dënuarve për krime sipas grup veprash penale	52
Personat e gjykuar dhe lloji i vendimeve të dhëna ndaj tyre	55
Personat e dënuar sipas rretheve gjyqësore	56
Të dënuarit, vepra kryesore për të cilën është dënuar dhe masa e dënimit	58
Disa nga rikualifikimet e veprave penale	64
KREU III	
Shpërndarja e kriminalitetit gjatë vitit 2008 bazuar në çështjet penale të përfunduara	69
Studimi i koeficientit të kriminalitetit	71
KREU IV	
Çështjet e gjykuara për krimet në gjykatat e shkallës së parë sipas Kodit Penal Ushtarak	75
Çështjet e gjykuara për kundërvajtje ushtarake	76
Mënyra e përfundimit të çështjeve penale ushtarake me vendime gjyqësore përfundimtare	77
Çështjet ushtarake	79
Ankimet	80
Krahasime të çështjeve ushtarake të gjykuara me një vit më parë	81
KREU V	
Kriminaliteti (të miturit)	85
Të dënuarit e mitur, vepra penale për të cilën dënohen dhe masa e dënimit	86
Krime të kryera nga femrat dhe numri i të dënuarave	88
Komente mbi të dënuarat femra	89
KREU VI	
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim	93

Aplikimi i nenit 59 nga gjykatat e rretheve gjyqësore	95
Aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore	98

KREU VII

Ngarkesa e gjyqtarëve 2008	103
Shpërndarja mesatare e volumit të punës në gjykata	110

KREU VIII

Analizë statistikore krahasuese për çështjet penale të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve	113
Çështje penale të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve	115
Çështje penale të përfunduara nga gjykatat e apeleve	116
Çështjet penale të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve	117
Vështrim i cilësisë së gjykimit për çështjet penale të shqyrtuara në periudhën e pesë viteve	118
Çështjet penale të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë	134
Numri i çështjeve penale të shqyrtuara sipas rretheve nga Gjykata e Lartë të shprehura në përqindje	138

KREU IX

Statistikat e çështjeve civile të regjistruara	143
Çështjet civile me/pa palë kundërshtare	145
Statistikat e çështjeve civile të përfunduara	147
Çështjet civile të përfunduara me/pa palë kundërshtare	149
Analizë krahasuese e padive civile të veçanta për katër vitet e fundit.....	151
Çështjet administrative.....	154
Çështjet civile me objekt marrëdhëniet e punës të përfunduara.....	157
Dinamika e çështjeve civile nga gjykatat e shkallës së parë.....	160
Mënyra e përfundimit të çështjeve civile	161
Çështjet civile të gjykuara sipas rretheve gjyqësore	162
Afatet e përfundimit të çështjeve civile	163
Ankimet e çështjeve civile të gjykuara në gjykatat e shkallës së parë.....	166
Volumi i punës për çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë.....	167
Zgjidhjet martesore	168

KREU X

Analizë statistikore për çështjet civile të gjykuara nga gjykatat e apelit.....	173
Çështje civile të përfunduara nga gjykatat e apeleve	175
Çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve të shprehura në përqindje	176
Vështrim i cilësisë së gjykimit për çështjet civile të shqyrtuara	178
Çështjet civile të shqyrtuara në Gjykatën e Lartë.....	190
Numri i çështjeve civile të shqyrtuara në Gjykatën e Lartë të shprehura në përqindje	194

KREU XI

Statistika analitike për çështjet penale & civile sipas rretheve gjyqësore.....	199
---	-----

KREU XII

Statistikat për procedimet penale dhe dinamikën e tyre në prokurori	223
Dinamika e çështjeve penale sipas prokurorive të rretheve gjyqësore	229
Tabela e ekzekutimit të vendimeve penale sipas rretheve	230
Tabela e vendimeve të paekzekutuara penale sipas rretheve	231
Tabela e ekzekutimit të vendimeve penale ushtarake	233
Tabela e vendimeve penale të paekzekutuara ushtarake	234

KREU XIII

Të dhënat statistikore të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor	238
Analiza statistikore të Përmbarimit në vitet 2006, 2007, 2008	239
Të dhënat statistikore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit për 2008	240

Të nderuar miq studiues,

Prezantimi i Vjetarit Statistikor tanimë nuk është thjesht dhe vetëm një përmbushje e detyrimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë. Ai përbën një gur themeli dhe mbështetjeje të mirë për analizat apo studimet e karakterit vlerësues dhe krahasues në fushën e drejtësisë si për ju, ashtu edhe për vetë Ministrinë e Drejtësisë duke u shndërruar në një prej mjeteve promovuese të sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, të shtimit të vullshëm të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe të transparencës në drejtësi, ka një tendencë dhe presion pozitiv për nxjerrjen e saktë, përpunimin dhe përdorimin e statistikave. Në këtë rrjedhë, Vjetari Statistikor bëhet një instrument i rëndësishëm për të nxitur njohuritë mbi sistemin e drejtësisë dhe mbi mekanizmat e ndryshëm ekzistues, duke lejuar identifikimin e problematikave dhe lehtësimin e zgjidhjeve të tyre.

Vjetari Statistikor 2008 prezanton në gjuhë numerike veprimtarinë njëvjeçare të gjykatave të shkallës së parë, të gjykatave të apelit, të Gjykatës së Lartë, të Prokurorisë së Përgjithshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Numrat hedhin dritë të hollësishme mbi llojet e mosmarrëveshjeve gjyqësore; mbi llojin, shtrirjen dhe përhapjen e kriminalitetit; mbi profilin e shkelësve të ligjit të kategorizuar mbi baza moshe e gjinie; mbi llojet e dënimit të shqiptuara nga gjykatat; mbi ecurinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore deri tek volumi i punës i përballuar nga operatorët e sistemit të drejtësisë.

Për përgatitjen e këtij vjetari punuan, dhe gjej rastin t'i falënderoj, jo vetëm stafi i brendshëm i Ministrisë së Drejtësisë, por edhe kancelarët dhe punonjësit e administratës të sistemit të drejtësisë. Vjetari Statistikor 2008 mund të gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, www.justice.gov.al, në rubrikën “Statistika” ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

Ndonëse ka një përmirësim të ndjeshëm nga viti në vit të paraqitjes së Vjetarit Statistikor, vizioni dhe sfida e Ministrisë së Drejtësisë për të ardhmen mbetet shtimi i rubrikës së analizës shkencore të këtyre statistikave të orientuar drejt rritjes së efektivitetit të sistemit të drejtësisë. Në përmbyllje të këtij angazhimi, ju uroj studim të mbarë të tij.

Ministri i Drejtësisë

Enkelejd Alibeaj



HYRJA

Sipas ligjit nr. 9180, datë 5. 02. 2004 **“Për statistikat zyrtare”**, me termin **“Statistikë”** kuptojmë të dhënat e përftuara nga përpunimi i të dhënave, për të karakterizuar fenomene kolektive në një popullim të dhënë.

Statistika juridike si një pjesë e statistikës së përgjithshme duke pasur kolektivitet krejt të veçantë studion gamën e gjerë të problemeve juridike që përmbledh dhe shërben si syri dhe mendja nga ku shikohet dhe bëhet anatomia e zhvillimit kualitativ dhe kuantitativ e pushtetit gjyqësor të një vendi.

Qëllimi ynë në këtë botim është krijimi i një statistike të unifikuar për drejtësinë, ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 **“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”**, i ndryshuar. Kjo është realizuar nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga më shumë se një burim dhe krijimit të një situatë ku të dhënat të interferohen duke verifikuar saktësinë e tyre. Kështu p.sh. të dhënat e marra nga Prokuroria e Përgjithshme për çështjet e dërguara për gjyq ballafaqohen me çështjet e ardhura të reja për gjykatën, ku merren në konsideratë edhe ato çështje të ardhura në gjykatë me ankim nga i dëmtuari akuzues, informacioni për urdhrat e ekzekutimit që jep prokuroria ballafaqohet me të burgosurit e rinj të ardhur në burgje ose çështjet e reja nga përmbartimi sipas rastit konkret; të dhënat për ankimet merren nga tre shkallët e gjykatave dhe konkludohet për saktësinë e tyre.

Në disa raste vërehet një luhatje në këto të dhëna që rrjedh si nga afatet procedurale të komunikimit dhe lëvizjes së çështjeve, ashtu edhe nga ndonjë gabim njerëzor në hedhjen e të dhënave, por të tilla mospërputhje janë me amplitudë të vogël.

Burimi kryesor në sigurimin e informacionit statistikor janë gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apeleve dhe Gjykata e Lartë. Marrëdhëniet me këto institucione krahas detyrimeve ligjore nëpërmjet ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe ligjit për prokurorinë, janë rregulluar nëpërmjet akteve nënligjore si urdhra dhe udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë, ku në fuqi janë **udhëzimi nr.99, datë 7. 01. 2002 “Për plotësimin e të dhënave statistikore”** dhe **udhëzimi nr. 324, datë 21. 01. 2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 99 datë 7. 01. 2002”**. Materiali statistikor sillet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë. Si rregull ky informacion plotësohet nga kancelari i gjykatës ose nën kujdesin e tij dhe kontrollohet nga kryetari i gjykatës.

Burim tjetër i rëndësishëm statistikor që shërben për pasqyrimin e të dhënave lidhur me hetimet paraprake, dinamikën e tyre dhe dërgimin e çështjeve për gjykim është **evidenca statistikore që Prokurori i Përgjithshëm sjell periodikisht në Ministrinë e Drejtësisë** dhe që realizohet në zbatim të ligjeve organike të dy institucioneve.

Drejtoritë e Përgjithshme të Burgjeve dhe të Përmbartimit mbyllin ciklin e grumbullimit të të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale dhe civile, duke plotësuar në tërësi të gjithë lëndën e parë me të cilën sektori i Statistikës së Unifikuar, Teknologjisë së Informacionit, Studimeve dhe Bibliografisë në Ministrinë e Drejtësisë ballafaqon dhe hedh të dhënat, operon me to për të hartuar informacionin përfundimtar të statistikës së unifikuar, model të cilin po e paraqesim nëpërmjet këtij vjetari.

Vlen të theksohet se informacionet dhe botimet statistikore të INSTAT-it sidomos regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë kanë shërbyer jo vetëm si përvojë dhe metodologji, por edhe si burim i freskët informacioni me të cilat bëhet i mundur përcaktimi i shumë parametrave

dinamikë që shprehin fenomene e dukuri specifike të mjediseve heterogjene. Me shumë interes në këtë kuadër është ndihma që jepet nga shfrytëzimi i këtij informacioni për studimin e shpërndarjes së kriminalitetit nëpërmjet përcaktimit të koeficientit të kriminalitetit për çdo rreth gjyqësor duke u dhënë gjyqtarëve të dhëna të domosdoshme që shërbejnë për politikën penale të dënimit dhe strukturave të tjera që merren me luftën ndaj krimit një orientim më shumë për llojin, volumin dhe strukturën e krimit në Shqipëri.

Studimi statistikor i fenomeneve dhe proceseve juridike ashtu si çdo studim i përgjithshëm statistikor kalon në tri faza:

1. Në vrojtim statistikor
2. Në përmbledhjen dhe grupimin e të dhënave
3. Në fazën e përpunimit dhe të analizës

Në këtë kontekst për lehtësi në kuptimin e materialit përfundimtar që kemi hartuar sqarojmë se jemi në kushtet e vrojtimit statistikor **me zgjedhje**, gjë që bën të mundur të mbledhen, grupohen, analizohen dukuritë **tipike** dhe **esenciale**, p.sh. llojet e çështjeve penale, paditë dhe kërkesat civile të shqyrtuara, mënyra e përfundimit dhe shpejtësia e gjykimit, politika e dënimit etj., por mund të mos gjenden të dhëna për të gjitha alternativat e dënimit me burgim etj., që në praktikën gjyqësore zbatohen më rrallë.

Duhet të kemi të qartë që duke e konsideruar tipiken dhe esencialen në dialektikën e saj, është e mundur që fenomene të tilla juridike e të tjera si këto të gjejnë dritën e shqyrtimit dhe studimit statistikor për të ardhmen.

Lehtësirat që krijon përdorimi i teknologjive të reja të komunikimit dhe informacionit, për sa i përket shkëmbimit të informacionit midis gjykatave të ndryshme dhe këtyre të fundit me Ministrinë e Drejtësisë do të përbëjë një prioritet për të ardhmen dhe do të krijojë mundësinë e thithjes së gjithë sasisë së informacionit statistikor.

Mendimet për përmirësim cilësor dhe sasior të të dhënave do të ishin të mirëpritura.

Në grupimin dhe përmbledhjen e materialit statistikor jemi përpjekur të bëjmë kujdes në ndarjen e kolektivitetit në grupe homogjene, d.m.th. bashkimin në grupe (klasa) të së njëjtës gjini e të të njëjtit tip, duke u bazuar në karakteristika të përbashkëta të tyre, si p.sh. ndarjen e çështjeve penale në krime dhe kundërvajtje; ndarjen e çështjeve civile në padi dhe kërkesa dhe akoma me tej në nënklasa si civile në përgjithësi, familjare, administrative, tregtare. Me interes është edhe kombinimi i grupimit kualitativ me atë kuantitativ për fenomenet juridike të studiuar.

Në këtë vjetar statistikor ndeshim edhe analiza e konkluzione të dukurive të veçanta të shoqëruara me paraqitje grafike ose me seri dinamike për rrethe gjyqësore, shkallë të ndryshme të gjyqësorit, por disa herë jepet edhe material bruto nga i cili mundet të veçohet elementi statistikor për të cilin interesohet përdoruesi i këtij informacioni.

Spektri i përdoruesve të këtij informacioni është i larmishëm nga pikëpamja profesionale.

Ky vjetar shërben për vendimmarrje, për qëllime studimore dhe për informim të publikut. Përdoruesit e tij janë autoritetet drejtuese të institucioneve që menaxhojnë problemet e drejtësisë, organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë, personalitete të shkencës dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, gazetarë të medias së shkruar dhe audiovizive, si dhe publiku në përgjithësi. Me interes është edhe domosdoshmëria që kanë kryetarët e gjykatave, kancelarët, dhe gjyqtarët për njohjen e realitetit të shifrave e fakteve më tej se gjykata e tyre. Në këto kushte ka qenë e nevojshme pajisja e vjetarit me sqarime për terma të veçantë juridikë dhe statistikorë më të përdorshëm, të cilët janë paraqitur dhe në gjuhën angleze.

Në këtë vjetar, volumin më të madh të materialit statistikor e përbëjnë të dhënat për gjykatat të trajtuar në dy kapituj kryesorë, për çështjet penale dhe civile në shkallë vendi, si dhe një kapitull për të dhënat analitike të volumit të punës, natyrës së çështjeve të përfunduara dhe modës së tyre për çdo gjykatë të veçantë. Informacioni me të dhënat e prokurorisë, përmbartimit, burgjeve është aksesiv, por tepër i domosdoshëm për të plotësuar tërësinë e të dhënave në fushën juridike.

➤ Disa nga konceptet statistikore më të përdorura

Me grupim kuptojmë ndarjen e masës në grupe homogjene nga pikëpamja cilësore. Grupimi bëhet në klasa të cilat duhet të përmbajnë tipe të ngjashme të kolektivitetit në aspektin cilësor dhe si rregull me numër të barabartë elementesh. Për natyrën që ka statistika juridike ndarja në klasa me numër të njëjtë elementesh është e pamundur, sepse krimet me kundërvajtjet penale që paraqesin ndryshimet cilësore nuk janë në numër të barabartë, gjithashtu kapituj të ndryshëm të Kodit Penal shoqërohen me numër jo të barabartë veprash penale. Për të shmangur këtë “anomali” përdoret koncepti i mesatares aritmetike dhe mesatares së ponderuar.

Grupimi mund të jetë kualitativ atëherë kur shprehet me fjalë p.sh. krime, kundërvajtje, familjare, tregtare, administrative etj.

Grupim kuantitativ atëherë kur shprehet me të dhëna që përmbajnë si p.sh. masën e dënimit, kohëzgjatja e gjykimit etj.

Modë quhet ajo vlerë e zgjedhjes që ka dendurinë më të madhe. E shprehur me fjalë të tjera moda tregon dukurinë më të shpeshtë në raport me fenomenet e tjera dhe e llogaritur për njësinë e vrojtimit. Në qoftë se të dhënat janë paraqitur në klasa, atëherë klasa me dendurinë më të madhe quhet klasë modale. Mund të ndodhë që të kemi më tepër se një klasë modale dhe raste të tilla kemi në disa rrethe gjyqësore ku p.sh. moda janë krimet kundër jetës dhe kundër rendit dhe sigurisë publike, si dhe kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike p.sh. në Shkodër, Vlorë etj.

Koeficienti i kriminalitetit tregon numrin e krimeve për 10 mijë apo 100 mijë banorë. Në këtë rast konkludohet më saktë për shpërndarjen e krimit në vend. Ky parametër shërben për të përcaktuar numrin e krimeve ose veprave penale të konsumuara duke i vënë këta në raport ideal me numrin e popullsisë së mjedisit shoqëror ku kryhet kjo vepër penale dhe për të cilin është dhënë një vendim përfundimtar. Në rritjen e këtij koeficienti sidomos për rrethet bregdetare apo kufitare ndikon edhe eksportimi i krimit.

Botimin e Vjetarit Statistikor për vitin 2008 do ta gjeni edhe në rrugë elektronike në sitin e Ministrisë së Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në adresën : www.justice.gov.al.

Në bazë të dekretit nr. 5350, datë 11.6.2007 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”, në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 11 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, në territorin e Republikës së Shqipërisë krijohen 21 rrethe gjyqësore me kompetenca tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1. Rrethi gjyqësor i Dibrës me qendër në Peshkopi, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Dibër e Bulqizë.
2. Rrethi gjyqësor i Sarandës me qendër në Sarandë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Sarandë e Delvinë.
3. Rrethi gjyqësor i Korçës me qendër në Korçë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Devoll e Kolonjë.
4. Rrethi gjyqësor i Kukësit me qendër në Kukës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Kukës e Has.
5. Rrethi gjyqësor i Beratit me qendër në Berat, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Berat, Skrapar e Kuçovë.
6. Rrethi gjyqësor i Shkodrës me qendër në Shkodër, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër e Malësi e Madhe.
7. Rrethi gjyqësor i Pukës me qendër në Pukë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pukës.
8. Rrethi gjyqësor i Fierit me qendër në Fier, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Fier dhe Mallakastër.
9. Rrethi gjyqësor i Elbasanit me qendër në Elbasan, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.
10. Rrethi gjyqësor i Durrësit me qendër në Durrës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Durrësit.
11. Rrethi gjyqësor i Kavajës me qendër në Kavajë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kavajës.
12. Rrethi gjyqësor i Gjirokastrës me qendër në Gjirokastrë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Përmet e Tepelenë.
13. Rrethi gjyqësor i Krujës me qendër në Krujë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Krujës.
14. Rrethi gjyqësor i Lezhës me qendër në Lezhë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet e Lezhës dhe Mirditës.
15. Rrethi gjyqësor i Kurbinit me qendër në Laç, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kurbinit.
16. Rrethi gjyqësor i Lushnjës me qendër në Lushnjë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Lushnjës.
17. Rrethi gjyqësor i Matit me qendër në Burrel, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Matit.
18. Rrethi gjyqësor i Pogradecit me qendër në Pogradec, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pogradecit.
19. Rrethi gjyqësor i Tiranës me qendër në Tiranë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tiranës.
20. Rrethi gjyqësor i Tropojës me qendër Bajram Curri, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tropojës.
21. Rrethi gjyqësor i Vlorës me qendër në Vlorë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Vlorës.

Me hyrjen në fuqi të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr. 2110, datë 29.5.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”.

KREU I


- ❖ **STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET PENALE & CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË**

STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE CIVILE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË (Statistics for Criminal and Civil cases examined by District courts)

Gjatë vitit 2008 janë shqyrtuar gjithsej **58063** çështje penale dhe civile nga **48086** çështje të shqyrtuara në vitin 2007, **60073** çështje të shqyrtuara në vitin 2006, **58149** çështje të shqyrtuara në vitin 2005, **48823** çështje të shqyrtuara në vitin 2004 dhe **45899** në vitin 2003.

Në mënyrë tabelare dhe grafike kemi panoramën si më poshtë:


Periudha (Period)	Çështje penale (Criminal cases)	Çështje civile (Civil cases)	Gjithsej (Total)
Viti (Year) 2003	5702	40197	45899
Viti (Year) 2004	7068	41755	48823
Viti (Year) 2005	6796	51353	58149
Viti (Year) 2006	7088	52985	60073
Viti (Year) 2007	6268	41818	48086
Viti (Year) 2008	7349	50714	58063



**STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE CIVILE TË REGJISTRUARA NGA
GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2008**
(Statistics for Criminal and Civil cases registered by District courts
for the year 2008)


Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Gjithsej të regjistruara (Total registered)	Regjistruar penale (Penal cases registered)	Regjistruar civile (Civil cases registered)
Berat	2765	379	2386
Dibër	1166	191	975
Durrës	6247	890	5357
Elbasan	4638	626	4012
Fier	3466	593	2873
Gjirokastrë	3562	407	3155
Kavajë	1439	190	1249
Korçë	5240	550	4690
Krujë	1345	175	1170
Kukës	932	157	775
Kurbin	1516	233	1283
Lezhë	2654	278	2376
Lushnjë	1886	217	1669
Mat	966	147	819
Pogradec	2081	199	1882
Pukë	644	105	539
Sarandë	2193	196	1997
Shkodër	4943	669	4274
Tiranë	18216	2267	15949
Tropojë	458	132	326
Vlorë	4817	685	4132
Krimet e Rënda	145	145	-
T O T A L I	71319	9431	61888

NUMRI I ÇËSHTJEVE PENALE & CIVILE TË REGJISTRUARA PËR VITIN 2008



**STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE DHE CIVILE TË GJYKUARA NGA
GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2008**
(Statistics for Criminal and Civil cases examined by District courts
for the year 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Gjithsej të përfunduara (Total examined)	Përfunduar penale (Penal cases examined)	Përfunduar civile (Civil cases examined)
Berat	2456	309	2147
Dibër	990	148	842
Durrës	5193	725	4468
Elbasan	3683	512	3171
Fier	3119	461	2658
Gjirokastrë	3108	317	2791
Kavajë	1207	152	1055
Korçë	4479	467	4012
Krujë	1094	125	969
Kukës	816	131	685
Kurbin	1301	191	1110
Lezhë	2407	227	2180
Lushnjë	1617	174	1443
Mat	848	111	737
Pogradec	1744	159	1585
Pukë	528	83	445
Sarandë	1815	137	1678
Shkodër	4478	542	3936
Tiranë	12910	1732	11178
Tropojë	378	101	277
Vlorë	3816	469	3347
Krimet e Rënda	76	76	-
T O T A L I	58063	7349	50714




STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE TË GJYKUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË SHPREHURA NË PËRQINDJE (Statistics for Criminal cases examined by District courts indicated in percentage)

Gjatë vitit 2008 janë regjistruar në total **10077** çështje penale, nga të cilat **9431** çështje penale sipas Kodit Penal (Civil) dhe **646** çështje penale sipas Kodit Penal Ushtarak.

Kanë përfunduar **7881** çështje penale, ku **7349** sipas KPC dhe **532** sipas KPU dhe kanë mbetur pa përfunduar **2196** çështje penale, nga të cilat **2082** sipas KPC dhe **114** sipas KPU.

Periudha (Period)	Çështje penale (Criminal cases)	Përqindja (Percentage)
Viti (Year) 2002	5466	12%
Viti (Year) 2003	5702	12%
Viti (Year) 2004	7068	15%
Viti (Year) 2005	6796	14%
Viti (Year) 2006	7088	15%
Viti (Year) 2007	6896	15%
Viti (Year) 2008	7881	17%



DINAMIKA E ÇËSHTJEVE PENALE (Dynamics of Criminal cases in 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Çështje të mbartura (Pending cases)	Ardhur të reja (New cases)	Ardhur pas prishjes (Cases to be retried)	Ardhur pas rihetimit (Cases to be re-investigated)	Gjithsej (Total)
Berat	67	311	1	0	379
Dibër	43	148	0	0	191
Durrës	218	665	7	0	890
Elbasan	164	461	1	0	626
Fier	123	467	3	0	593
Gjirokastrë	80	326	1	0	407
Kavajë	25	162	2	1	190
Korçë	79	468	3	0	550
Krujë	37	134	4	0	175
Kukës	14	141	2	0	157
Kurbin	53	176	4	0	233
Lezhë	62	210	5	1	278
Lushnjë	54	162	1	0	217
Mat	13	133	1	0	147
Pogradec	52	143	4	0	199
Pukë	18	84	3	0	105
Sarandë	32	161	3	0	196
Shkodër	101	543	19	6	669
Tiranë	573	1640	29	25	2267
Tropojë	34	93	5	0	132
Vlorë	162	510	11	2	685
Krimet e Rënda	62	72	10	1	145
T O T A L I	2066	7210	119	36	9431

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE (Way of termination for criminal cases)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Me vendim fajësie (By plea of guilty)	Me vendim pafajësie (By plea of not guilty)	Çështje të pushuara (Ceased cases)	Kthyerë për plotësim hetimesh (Cases to be re-investigated)	Vendosur inkompetenca (Lack of competence)	SHUMA (Total)
Berat	262	6	38	1	2	309
Dibër	129	9	6	2	2	148
Durrës	640	21	57	5	2	725
Elbasan	388	11	94	16	3	512
Fier	399	9	42	6	5	461
Gjirokastrë	244	17	40	14	2	317
Kavajë	131	1	13	3	4	152
Korçë	396	24	40	6	1	467
Krujë	106	2	13	4	0	125
Kukës	103	5	17	4	2	131
Kurbin	169	4	16	2	0	191
Lezhë	202	5	14	6	0	227
Lushnjë	134	6	25	8	1	174
Mat	67	4	9	29	2	111
Pogradec	104	14	38	3	0	159
Pukë	39	6	36	2	0	83
Sarandë	101	2	31	3	0	137
Shkodër	474	27	22	16	3	542
Tiranë	1597	61	55	16	3	1732
Tropojë	79	4	17	0	1	101
Vlorë	399	19	38	7	6	469
Krimet e Rënda	70	0	0	4	2	76
T O T A L I	6233	257	661	157	41	7349

ÇËSHTJET PENALE SIPAS RRETHEVE
(Criminal cases examined by district courts in 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Pa përfunduar (Pending)
Berat	379	309	70
Dibër	191	148	43
Durrës	890	725	165
Elbasan	626	512	114
Fier	593	461	132
Gjirokastrë	407	317	90
Kavajë	190	152	38
Korçë	550	467	83
Krujë	175	125	50
Kukës	157	131	26
Kurbin	233	191	42
Lezhë	278	227	51
Lushnjë	217	174	43
Mat	147	111	36
Pogradec	199	159	40
Pukë	105	83	22
Sarandë	196	137	59
Shkodër	669	542	127
Tiranë	2267	1732	535
Tropojë	132	101	31
Vlorë	685	469	216
Krimet e Rënda	145	76	69
T O T A L I	9431	7349	2082

**NDARJA E ÇËSHTJEVE PENALE NË KRIME & KUNDËRVAJTJE PENALE TË
GJYKUARA NË GJYKATAT E RRETHEVE GJYQËSORE**
(Division of Criminal Affairs In Crime & Criminal Offenses Tried in District Courts)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Përfunduar penale (Penal cases examined)	Përfunduar krime (Examined crime offenses)	Përfunduar kundërvajtje penale (Examined Contraventions)
Berat	309	170	139
Dibër	148	94	54
Durrës	725	515	210
Elbasan	512	233	279
Fier	461	325	136
Gjirokastrë	317	187	130
Kavajë	152	106	46
Korçë	467	287	180
Krujë	125	79	46
Kukës	131	50	81
Kurbini	191	105	86
Lezhë	227	145	82
Lushnjë	174	97	77
Mat	111	70	41
Pogradec	159	76	83
Pukë	83	21	62
Sarandë	137	69	68
Shkodër	542	357	185
Tiranë	1732	1324	408
Tropojë	101	61	40
Vlorë	469	339	130
Krimet e Rënda	76	76	0
T O T A L I	7349	4786	2563


ÇËSHJTJE PENALE GJITHSEJ TË GJYKUARA PËR VITIN 2008

(Total Criminal cases examined for the year 2008)

Të dhënat e mëposhtme paraqesin volumin e punës së gjykatave për rrethet gjyqësore duke përfshirë çështjet penale dhe çështjet penale ushtarake. Të dhënat për këto çështje janë llogaritur në totalin e të dhënave të rretheve si vijon:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Përfunduar (Terminated cases)	Përfunduar çështjet ushtarake (Terminated military criminal cases)	Përfunduar (Terminated cases)
Berat	309	18	327
Dibër	148	0	148
Durrës	725	2	727
Elbasan	512	0	512
Fier	461	0	461
Gjirokastrë	317	17	334
Kavajë	152	1	153
Korçë	467	11	478
Krujë	125	0	125
Kukës	131	3	134
Kurbin	191	0	191
Lezhë	227	0	227
Lushnjë	174	0	174
Mat	111	2	113
Pogradec	159	0	159
Pukë	83	0	83
Sarandë	137	0	137
Shkodër	542	52	594
Tiranë	1732	178	1910
Tropojë	101	0	101
Vlorë	469	248	717
Krimet e Rënda	76	0	76
T O T A L I	7349	532	7881


NUMRI I ÇËSHITJEVE PENALE TË PËRFUNDUARA PËR VITIN 2008



**SERIA DINAMIKE E KËRKESAVE PENALE SIPAS GJYKATAVE
TË RRETHEVE**
(Dynamics of Criminal requests according to district courts)

Për vitin 2008 numri i kërkesave penale është **11689** kërkesa. Ky numër ka pësuar një ulje në krahasim me kërkesat penale të vitit 2007, ku ka pasur **12550** kërkesa penale dhe konkretisht **861** kërkesa penale më pak.. Në krahasim me kërkesat penale të vitit 2006, ku ka pasur **11623** kërkesa penale kemi një rritje prej **66** kërkesash penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Kërkesa penale (gjithsej) (A total of criminal requests)
Berat	408
Dibër	192
Durrës	1253
Elbasan	2000
Fier	644
Gjirokastrë	142
Kavajë	624
Korçë	807
Krujë	624
Kukës	165
Kurbin	121
Lezhë	1022
Lushnjë	174
Mat	450
Pogradec	159
Pukë	108
Sarandë	45
Shkodër	750
Tiranë	1315
Tropojë	113
Vlorë	362
Krimet e Rënda	211
T O T A L I	11689




SHPEJTËSIA E GJYKIMIT (Period of termination for criminal cases)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	A F A T E T (Term of termination)			
	0-2 muaj (0-2 months)	2-6 muaj (2-6 months)	6 muaj-1 vit (6 months-1 year)	mbi 1 vit (Over 1 year)
Berat	184	112	10	3
Dibër	105	40	2	1
Durrës	399	249	61	16
Elbasan	290	164	52	6
Fier	241	155	47	18
Gjirokastrë	178	111	26	2
Kavajë	127	20	3	2
Korçë	335	118	13	1
Krujë	87	27	11	0
Kukës	85	34	6	6
Kurbin	113	64	14	0
Lezhë	109	87	30	1
Lushnjë	93	65	14	2
Mat	84	23	4	0
Pogradec	55	83	19	2
Pukë	47	35	1	0
Sarandë	77	54	5	1
Shkodër	308	166	52	16
Tiranë	586	827	234	85
Tropojë	68	22	4	7
Vlorë	176	194	69	30
Krimet e Rënda	12	29	17	18
T O T A L I	3759	2679	694	217

VOLUMI I PUNËS PËR 7 VITET E FUNDIT PËR ÇËSHTJET PENALE (Workload on criminal cases for the seven last years)


Nga tabela e mëposhtme vëmë re se volumi i punës për 7 (shtatë) vitet e fundit (2002-2008), për çështjet penale ka pësuar ndryshime. Në vitin 2008 çështjet penale kanë pësuar rritje prej **985** çështjesh në krahasim me vitin paraardhës dhe **793** çështje më shumë se në vitin 2006. Për vitin 2008 në krahasim me vitin 2005, volumi i punës ka pësuar rritje me **1085** çështje penale të përfunduara më shumë, për vitin 2004 volumi i punës ka pësuar rritje me **813** çështje penale të përfunduara më shumë. Në krahasim me vitin 2001, vitin 2002, vitin 2003 ky volum pune ka pësuar rritje të ndjeshme. Volumi i punës në vitin 2008 ka pësuar rritje në krahasim me të gjitha vitet e mëparshme.

Çështjet penale (Criminal cases)	Viti (Year) 2002	Viti (Year) 2003	Viti (Year) 2004	Viti (Year) 2005	Viti (Year) 2006	Viti (Year) 2007	Viti (Year) 2008
Të përfunduara (Terminated cases)	5471	6420	7068	6796	7088	6896	7881



KRAHASIMI I DINAMIKËS SË ÇËSHTJEVE PENALE PËR SHTATË VITET E FUNDIT (Comparison of dynamics of criminal cases for the seven last years)

Periudha (Period)	Viti (Year) 2002	Viti (Year) 2003	Viti (Year) 2004	Viti (Year) 2005	Viti (Year) 2006	Viti (Year) 2007	Viti (Year) 2008
Gjithsej (Total)	6392	7325	9181	8823	9099	9201	10077
Përfunduar (Examined)	4891	5702	7068	6796	7088	6896	7881
Pa përfunduar (Pending)	1501	1623	2113	2027	2011	2305	2196



Në tabelën e mësipërme përfshihet dinamika e numrit të çështjeve penale dhe çështjeve penale ushtarake.

KREU II

- ❖ KLASIFIKIMI I ÇËSHTJEVE PENALE
& ANKIMIMET

KLASIFIKIMI I ÇËSHTJEVE PENALE DHE ANKIMIMET (Classification of criminal cases and complaints)

Nga **7881** çështje penale të përfunduara; sipas Kodit Penal janë gjykuar **7349** çështje penale dhe sipas Kodit Penal Ushtarak **532** çështje penale.

Në vijim po analizojmë çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal, sepse çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal Ushtarak trajtohen në një kapitull të veçantë.

Ndër çështjet e gjykuara sipas Kodit Penal **7349**, çështje të përfunduara për krime janë **4786** dhe ato për kundërvajtje janë **2563**. Në tërësi krimet zënë **65%** të veprave penale, ndërsa kundërvajtjet **35%** të tyre. Në këto të dhëna nuk merren në konsideratë rastet kur në një çështje penale janë konsumuar më shumë sesa një vepër penale.

Kërkesa penale ku përfshihen kryesisht masat e sigurimit dhe të gjitha kërkesat e tjera të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe që përbëjnë volumnin e punës për gjykatat e shkallës së parë për vitin 2008 janë **11689** kërkesa penale.

Krahasimisht me vitet paraardhëse ky numër ka pësuar ulje të lehtë, në krahasim me vitin 2007 ku kishim **12550** kërkesa penale, pra numri i kërkesave penale ka pësuar një ulje prej **861** kërkesash. Duke e krahasuar me vitin 2006 ku kishim **11623** kërkesa penale ky numër është pothuajse i njëjtë dhe krahasimisht me vitin 2005 ku kishim **7551** kërkesa penale ka pësuar një rritje të ndjeshme prej **4138** kërkesa penale më tepër.

Nga **11689** kërkesa penale gjithsej, **2850** janë masë sigurimi arrest me burg, **817** janë masë sigurimi arrest shtëpie, **988** janë masë sigurimi detyrim paraqitjeje, **165** janë masë sigurimi arrest në mungesë, **527** janë rivlerësim i masës së sigurimit, **148** janë masa për vendosjen e garancisë pasurore, **50** janë njohje e vendimeve penale të huaja dhe **6144** janë kërkesa të tjera penale.

Numrin më të madhe të kërkesave penale në shkallë vendi e zë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me 2000 kërkesa penale.

Gjeografia e çështjeve penale të përfunduara është e larmishme duke përfshirë çështje nga të gjithë kapitujt e Kodit Penal, por denduria dhe intensiteti i tyre është disproporcional.

Kështu, po të analizojmë disa nga të dhënat e çështjeve penale të përfunduara sipas kapitujve apo grup veprash penale gjendja paraqitet si më poshtë:

- ☐ Krime kundër jetës të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 76-85) janë përfunduar **242** çështje
- ☐ Krime kundër shëndetit të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 86 - 99) kemi **97** çështje
- ☐ Krimet seksuale të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 100 -108) janë përfunduar **38** çështje
- ☐ Krime kundër lirisë së personit të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 109 -111) përfunduar **25** çështje
- ☐ Krime kundër moralit, dinjitetit dhe familjes të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 113 -129) përfunduar **126** çështje
- ☐ Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 134 – 195) janë **2637** çështje
- ☐ Krimet kundër autoritetit të shtetit & veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 235 - 299) kanë **1460** çështje të përfunduara

- ❑ Krimet kundër drejtësisë të parashikuar në Kodin Penal në (nenet 300-324) kanë **109** çështje
- ❑ Krime të tjera **52** çështje

Nga analiza e këtyre të dhënave konkludohet se përsa i përket sasisë së çështjeve penale të përfunduara **moda** është klasa e çështjeve penale që përfshijnë krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të cilat totalisht përbëjnë **2637** çështje penale ose **55 %** të të gjitha krimeve të gjykuara në vend që janë **4786** çështje.

Për sa i përket intensitetit të çështjeve për çdo krim përsëri **moda e çështjeve të përfunduara është ajo e krimeve kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, sepse mesatarisht për çdo vepër penale në këtë grupim kemi 26 krime duke lënë në vend të dytë krimet kundër autoritetit të shtetit me 18 krime, në vend të tretë krime kundër jetës me 13 krime mesatarisht për çdo figurë vepre penale. Është për t'u përmendur që edhe në vitin 2007, 2006 dhe 2005 këto tre kategori veprash penale kishin intensitetin më të lartë. Konstatohet se intensiteti i çështjeve të përfunduara për krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka pësuar ulje në krahasim me vitet 2005, 2006 dhe 2007.**

Kështu në vitin 2007, për krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike mesatarisht për çdo vepër penale në këtë grupim kishim 40 krime duke lënë në vend të dytë krimet kundër autoritetit të shtetit me 21 krime, në vend të tretë krime kundër jetës me 21 krime mesatarisht për çdo figurë vepre penale.

Për vitin 2008 intensiteti i çështjeve të përfunduara për krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike është rritur në 2637 çështje, pra 315 çështje më shumë se në vitin 2007.

Krimet më të pakta në numër të ndeshura sipas kësaj ndarje për vitin 2008 janë ato në fushën e drejtësisë kundër lirisë së personit dhe ato seksuale me respektivisht 10, 10.4 dhe 3.5 krime për çdo vepër penale të këtyre fushave.

Lidhur me grupveprat penale në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 kemi :

- ❑ **Grupveprat penale krime kundër jetës** kemi **45** çështje penale më shumë (nga **220** çështje penale në vitin 2006 në **197** çështje penale në vitin 2007 dhe **242** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër shëndetit** **20** çështje penale më shumë, (nga **81** çështje penale në vitin 2006 në **77** çështje penale në vitin 2007 dhe **97** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krime seksuale** **2** çështje penale më pak, (nga **37** çështje penale në vitin 2006 në **40** çështje penale në vitin 2007 dhe **38** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër lirisë së personit** **10** çështje penale më shumë, (nga **23** çështje penale në vitin 2006 në **15** çështje penale në vitin 2007 dhe **25** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër moralit, dinjitetit dhe familjes** **28** çështje penale më shumë, (nga **95** çështje penale në vitin 2006 në **98** çështje penale në vitin 2007 dhe **126** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** me **315** çështje penale më shumë (nga **2429** çështje penale në vitin 2006 në **2322** çështje penale në vitin 2007 dhe **2637** çështje penale në vitin 2008);

- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër autoritetit të shtetit** me **179** çështje penale më shumë, (nga **1116** çështje penale në vitin 2006 në **1281** çështje penale në vitin 2007 dhe **1460** çështje penale në vitin 2008);
- ❑ **Grupveprat penale krimet kundër drejtësisë** me **33** çështje penale më shumë, (nga **83** çështje penale në vitin 2006 në **76** çështje penale në vitin 2007 dhe **109** çështje penale në vitin 2008);

Është një numër i **përafërt i çështjeve** të përfunduara për **krimet kundër moralit, dinjitetit dhe familjes, për krimet kundër lirisë së personit dhe krimet seksuale**.

Nga **7349** çështje penale të përfunduara sipas Kodit Penal janë ankimuar **2753** çështje në apel që përbejnë **37 %** të tyre. Nga ankimimet në **871** raste kemi apel të prokurorit në **2240** kemi apel të të pandehurit.

Konkludohet që në 358 raste apelimi ka qenë nga të dyja palët.

Shprehur në % për çështjet e ankimuara 13 % të ankimimeve janë nga prokurori dhe i pandehuri njëkohësisht.

Krahasuar me të dhënat për apelimet e dy viteve më parë kemi një rritje të çështjeve penale të apeluara. Në vitin 2008 ka pasur një rritje prej **948** ankimime penale në krahasim me vitin 2007 numër i cili reflektohet më shumë në ankimimet e bëra nga i pandehuri me **738** ankimime më shumë se në vitin 2007. Në vitin 2008 në krahasim me vitin 2006 kemi rritje prej **617** çështje penale të apeluara.

**SERITË DINAMIKE QË TREGOJNË ANKIMIMET NË
GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË**
(Dynamics indicating the complaints in the first instance courts)


Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	ANKIMIME (Complaints)						
	Apelim i prokurorit (Prosecutor's appeal)	Apelim i të pandehurit (Defendant's appeal)	Çështje të apeluara (Appealed cases)	Rekursi i prokurorit (Prosecutor's recourse)	Rekursi i të pandehurit (Defendant's recourse)	Gjithsej rekurse (A total of recourses)	Gjithsej ankime (A total of complaints)
Berat	37	75	90	0	0	0	90
Dibër	17	53	70	2	2	4	74
Durrës	145	264	328	0	0	0	328
Elbasan	30	131	161	0	0	0	161
Fier	50	200	229	0	0	0	229
Gjirokastrë	33	109	142	15	27	42	184
Kavajë	6	62	66	0	0	0	66
Korçë	42	195	223	0	0	0	223
Krujë	34	49	65	0	0	0	65
Kukës	10	15	25	0	0	0	25
Kurbin	38	42	77	2	0	2	79
Lezhë	13	66	73	0	0	0	73
Lushnjë	26	57	46	0	0	0	46
Mat	13	23	29	0	0	0	29
Pogradec	16	32	48	1	1	2	50
Pukë	16	12	28	2	2	4	32
Sarandë	1	32	33	0	0	0	33
Shkodër	96	179	239	0	0	0	239
Tiranë	156	473	569	18	4	20	589
Tropojë	35	56	91	8	13	23	114
Vlorë	7	52	56	0	0	0	56
Krimet e Rënda	50	63	65	6	4	6	71
TOTALI	871	2240	2753	54	53	103	2856

A P E L I M E T (APPEALS)

Në vitin 2008 numri i çështjeve të apeluara ka qenë **2753** çështje penale. Në vitin 2007 ky numër çështjesh penale të apeluara ka qenë **1805** çështje. Në vitin 2006 ky numër çështjesh penale të apeluara ka qenë **1950** çështje. Në vitin 2005 ky numër çështjesh penale të apeluara ka qenë **2608**.

Duke krahasuar këto katër (4) vitet e fundit mund të themi se në vitin 2008 kemi pasur ***një rritje të ndjeshme*** prej **948** ankimime penale në krahasim me vitin 2007, ***një rritje*** prej **803** ankimime penale në krahasim me vitin 2006 dhe një ***rritje*** prej **145** ankimime penale në krahasim me vitin 2005. Ky numër reflektohet më shumë në ankimimet e bëra nga i pandehuri, i cili nga **2095** ankimime që ka qenë në vitin 2005, në **1623** ankimime të bëra në vitin 2006, **1502** ankimime të bëra në vitin 2007 dhe **2240** ankimime të bëra në vitin 2008.

Periudha (Period)	Apelime gjithsej (A total of appeals)	Apeli i prokurorit (Prosecutor's appeal)	Apeli i të pandehurit (Defendant's appeal)
Viti (Year) 2005	2608	875	2095
Viti (Year) 2006	1950	608	1623
Viti (Year) 2007	1805	507	1502
Viti (Year) 2008	2753	871	2240




REKURSE TË DREJTPËRDREJTA (DIRECT RECOURSES)

Numri i çështjeve penale për të cilat është bërë rekurs ka qenë **103** çështje penale për vitin 2008, në krahasim me **54** çështje penale për vitin 2007, në krahasim me **167** çështje penale për të cilat është bërë ankim në vitin 2006, në krahasim me **137** çështje penale për të cilat është bërë ankim në vitin 2005.

Pra rezulton se kemi pasur ***një rritje të ndjeshme*** prej **49** çështjesh penale për të cilat është bërë rekurs në këtë vit. Kjo pasqyrohet si në çështjet penale të ankimuara me kërkesën e prokurorit, ashtu edhe në çështjet penale të ankimuara me kërkesën e të pandehurit.

Periudha (Period)	Rekurse gjithsej (A total of recourses)	Rekursi i prokurorit (Prosecutor's recourse)	Rekursi i të pandehurit (Defendant's recourse)
Viti (Year) 2005	137	57	83
Viti (Year) 2006	167	75	112
Viti (Year) 2007	54	31	24
Viti (Year) 2008	103	54	53



ÇËSHTJET E GJYKUARA, KRIMET (Offences)

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
76	Vrasje me dashje (Intentional Murder)	112	96
77	Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër (Murder connected to another crime)	1	2
78/1	Vrasja me paramendim (Premeditated homicide)	63	64
78/2	Vrasje me paramendim për gjakmarrje (Premeditated bloodfeud homicide)	12	15
79	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (Murder for reasons of special qualities of the victim)	26	29
79/a	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (Murder for reasons of special qualities of the victim)	1	1
79/b	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (Murder for reasons of special qualities of the victim)	2	2
79/c	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (Murder for reasons of special qualities of the victim)	3	12
79/dh	Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (Murder for reasons of special qualities of the victim)	6	8
82	Vrasje në kushtet e tronditjes së rëndë psikike (Homicide committed in a state of profound psychiatric distress).	5	7
83	Vrasje të kryera me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (Homicide committed by exceeding self-defense).	3	1
85	Vrasje nga pakujdesia (Negligent homicide in the Albanian original).	8	8
88	Plagosje e rëndë me dashje (Torture resulting into serious consequences)	65	60
88/a	Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së rëndë psikike (Serious intentional injury in a state of profound psychiatric distress)	15	21
88/b	Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (Serious intentional injury through the use of excessive force for self-defense).	7	8
89/a	(Shtuar me ligjin nr.8204, datë 10.04.1997, neni 1)	1	0
96	Mjekimi i pakujdesshëm (Incorrect medication)	4	2
99	Shkaktimi i vetëvrasjes (Causing suicide)	5	5
100/1	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (Intercourse with minors)	9	9

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
100/2	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (Intercourse with minors)	5	6
101/1,2	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç (Intercourse with minors between fourteen to eighteen)	8	5
102	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (Nonconsensual sexual intercourse with mature women)	9	7
102/a	Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur (Nonconsensual sexual intercourse with mature persons)	2	0
108	Vepra të turpshme (Serious immoral acts)	5	6
109/1	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit (Kidnapping)	1	7
109/2,3	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit (Kidnapping)	3	3
109/a	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese (Kidnapping in mitigating circumstances)	3	5
109/b	Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	5	3
110/2	Heqja e paligjshme e lirisë (Unlawful detention)	13	23
113	Prostitucioni (Prostitution)	44	53
114	Shfrytëzimi i prostitucionit (Exploitation of prostitution)	13	11
114/a	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Exploitation of prostitution with aggravated circumstances)	16	25
114/a1	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Exploitation of prostitution with aggravated circumstances)	5	7
114/a2	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Exploitation of prostitution with aggravated circumstances)	2	1
114/a4	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Exploitation of prostitution with aggravated circumstances)	1	2
114/a5	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (Exploitation of prostitution with aggravated circumstances)	7	9
114/b1	Trafikimi i femrave për prostitucion (Traffic of women for prostitution)	3	2
114/b2	Trafikimi i femrave për prostitucion (Traffic of women for prostitution)	7	10
114/b3	Trafikimi i femrave për prostitucion (Traffic of women for prostitution)	2	3
115	Mbajtja e lokaleve për prostitucion (Use of premises for prostitution)	4	4

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
118	Dhunimi i varreve (Desecration of graves)	8	10
124	Braktisja e fëmijëve të mitur (Abandonment of minor children)	7	5
128/b1	Trafikimi i të miturve (Traffic of minoren)	3	2
128/b3	Trafikimi i të miturve (Traffic of minoren)	2	1
128/b4	Trafikimi i të miturve (Traffic of minoren)	2	1
134/1	Vjedhja (Theft)	635	623
134/2	Vjedhja (Theft)	403	776
134/3	Vjedhja (Theft)	11	11
135	Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën (Theft through abuse of office)	31	30
136	Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit (Bank robbery)	2	2
137/2	Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve të telefonit (Stealing electrical power or telephone lines)	152	23
139	Vjedhja me dhunë (Robbery)	50	71
140	Vjedhja me armë (Robbery with the use of weapons)	25	32
141	Trafikimi i mjeteve motorike (Traffic of motoric equipment)	5	6
141/a	Trafikimi i mjeteve motorike (Traffic of motoric equipment)	15	14
141/a1	Trafikimi i mjeteve motorike (Traffic of motoric equipment)	1	0
141/a2	Trafikimi i mjeteve motorike (Traffic of motoric equipment)	2	3
142	Sigurimi i mjeteve për vjedhje (Providing equipment for theft)	5	3
143	Mashtrimi (Deception)	181	167
143/a	Skemat mashtruese dhe piramidale (Fraudulent schemes)	2	12
145	Mashtrimi në sigurime (Insurance fraud)	10	8
146	Mashtrimi në kredi (Fraud on credit)	2	8
150	Shkatërrimi i pronës (Destruction of property)	61	63
151	Shkatërrimi i pronës me zjarr (Destruction of property by fire)	34	35

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
152	Shkatërrimi i pronës me eksploziv (Destruction of property by explosives)	8	10
154	Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera (Destruction of property with other means)	2	1
159/1	Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit (Destruction of water-supply system)	1	9
161	Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia (Destruction of property due to lack of negligence)	8	6
164	Shpërdorimi i kompetencave (Abuse of powers)	1	0
164/b	Korrupsioni pasiv në sektorin privat (Passive corruption in the private sector)	1	1
172	Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë (Smuggling goods to which excise duty is applied)	7	8
173	Kontrabanda me mallra të licencuara (Smuggling goods requiring license)	0	1
174	Kontrabanda me mallra të tjera (Smuggling other goods)	51	55
175	Kontrabanda nga punonjës që lidhen me vepr. doganore (Smuggling carried out by custom officials)	1	1
176	Kontrabanda e vlerave kulturore (Smuggling [goods with] cultural value)	1	0
177	Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm (Smuggling goods holding intermediate status)	3	4
178	Tregtimi dhe transportimi mallrave që janë kontrabandë (Divulging and transporting of smuggled goods)	64	62
179	Ruajtja dhe depozitimi i mallrave që janë kontrabandë (Storing smuggled goods)	15	15
181	Mospagimi i taksave dhe tatimeve (Non payment of taxes)	53	22
181/a2	Moskryerja e detyrave nga organet tatimore (Non completion of duties from tax authorities)	1	1
183	Falsifikimi i monedhave (Falsifying currency)	16	19
184	Falsifikimi i letrave me vlerë (Falsifying negotiable instruments)	2	2
186	Falsifikimi i dokumenteve (Falsifying documents)	283	295
187	Falsifikimi i dokumenteve shkollore (Falsifying school documents)	57	68
188	Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore (Falsifying health-related documents)	1	0
189	Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave (Falsifying identity cards or visas)	269	275
190	Falsifikimi i vulave, stampave apo formularëve (Falsifying seals, labels or application forms)	114	119
191/2,3	Falsifikimi i akteve të gjendjes civile (Falsifying acts of civil records)	49	40
192/a	Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve (Destruction and theft of documents)	1	4
192/b	Ndërhyrja e transmetimet kompjuterike (Intervention on computer communications)	1	1

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
221	Kryengritja (Insurgency)	1	0
227	Fyerja ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja (Insult of state representatives)	1	3
235/2	Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik (Opposing the public official)	10	10
236/2	Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik (Opposing the official of the public order police)	47	126
237	Goditje për shkak të detyrës (Assault to an official on duty)	97	103
244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike Active corruption of persons who exercise public functions	4	8
245	Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë Active corruption of high state officials or of local electives	2	3
245/1	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike Exercise of illegal influence over persons who exercise public functions	1	0
246/2	Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore (Appropriating a public title or office)	4	3
248	Shpërdorimi i detyrës (Abuse of office)	97	81
250	Kryerja e veprimeve arbitrare (Committing arbitrary acts)	10	11
254	Shkelja e paprekshmërisë së banesës (Infringing the inviolability of residence)	1	0
257	Përfitimi i paligjshëm interesave (Illegal benefiting from interests)	2	2
257/a2	Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë Refusal to declare, denial to declare, concealment or fictive declaration of wealth of electives or civil servants	2	2
258	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike (Breaching the equality of participants in public bids or auctions)	1	26
259	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike Passive corruption of persons who exercise public functions	13	22
260	Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë Passive corruption of high state officials or of local electives	0	1

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
278/1	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit (Illegal manufacturing and keeping military weapons and ammunition)	10	19
278/2	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit (Illegal manufacturing and keeping military weapons and ammunition)	357	364
278/4	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit (Illegal manufacturing and keeping military weapons and ammunition)	2	4
278/a	Trafikimi i armëve e municionit (Traffic of military weapons and ammunition)	2	2
279	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta (Illegally manufacturing and keeping weapons with blades)	49	39
282/2	Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive (Breach of rules on explosive, flammable or radioactive substances)	1	0
282/a	Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive (Trafficking of explosives, flammable or radioactive substances)	0	3
283	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (Manufacturing and selling narcotics)	40	37
283/1	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (Manufacturing and selling narcotics)	106	128
283/2	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (Manufacturing and selling narcotics)	39	59
283/a	Trafikimi i narkotikëve (Traffic of narcotics)	2	0
283/a1	Trafikimi i narkotikëve (Traffic of narcotics)	7	4
283/a2	Trafikimi i narkotikëve (Traffic of narcotics)	19	42
283/a3	Trafikimi i narkotikëve (Traffic of narcotics)	2	1
283/b	Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës (Facilitating of taking and usage of narcotics)	1	1
284	Kultivimi i bimëve narkotike (Cultivating narcotic plants)	30	22
284/1	Kultivimi i bimëve narkotike (Cultivating narcotic plants)	22	20
284/a	Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale (Organizing and leading criminal organizations)	1	1

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
285	Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike (Keeping, manufacturing and transporting of narcotic plants)	3	3
285/a	Përshtatja e lokalit për përdorim droge (Storing equipment for useing narcotics)	0	1
287	Pastrimi i produkteve të veprës penale (Disposing ¹ of proceeds of crime)	2	1
287/a	Çelja e llogarive anonime (Opening of anonymous accounts)	0	1
287/b	Përvetësimi i parave ose mallrave të vjedhura (Appropriation of money or stolen goods)	3	5
288	Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin (Producing and selling foods and other substances dangerous to the health)	2	1
288/a2	Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore (Illegal producing of industrial and foods products)	4	4
289	Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë (Breach of rules of work-related protection)	12	10
290	Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (Breach of traffic regulations)	338	326
293	Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit (Blocking transportation)	3	12
298	Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (Assisting illegal crossing of borders)	91	53
298/1	Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (Assisting illegal crossing of borders)	8	24
298/2	Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (Assisting illegal crossing of borders)	6	32
298/3	Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (Assisting illegal crossing of borders)	7	29
300	Moskallëzimi i krimit (Failure to report a crime)	12	78
301	Veprimet që pengojnë zbulimin e së vërtetës (Obstruction of justice)	4	15
302	Përkrahja e autorit të krimit (Harboring a fugitive)	5	13
303	Fshehja ose asgjësimi i kufomës (Hiding or disfiguring a corpse beyond recognition)	0	1
305	Kallëzim i rremë (False report)	58	66
306/2	Dëshmia e rreme (Perjury)	10	4

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
307/2	Refuzimi për të dëshmuar (Refusing to testify)	1	0
312	Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit (Activ corrupting of testimony, expertise or translation)	1	0
316	Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit (Opposing and assaulting a judge)	3	2
317	Kanosja e gjyqtarit (Threat to a judge)	1	1
323	Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit (Escape of the convicted from the place of detention)	13	11
324	Dhënia ndihmë e një të burgosuri për largim (Assisting a fugitive)	1	0
326	Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve (Falsifying documents and election results)	2	3
Ligji nr.9662	"Për bankat në Republikën e Shqipërisë" Law 9662 "On banks in the Republic of Albania"	39	39
Të tjera	Others	9	0
TOTALI PËR KRIME		4786	5349

*** Shënime.**

Në rubrikën **Çështje** janë përfshirë të dhënat për dosjet gjyqësore të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme me emërtimin e akuzës më të rëndë (me dënimin maksimal).

- ☐ Rubrika **Vepra** pasqyron të dhënat ku përfshihen përveç akuzës kryesore edhe veprat penale të tjera të konsumuara, sepse në shumë çështje mund të jetë konsumuar më tepër se një vepër penale.
- ☐ Te rubrika të **Dënuar** janë pasqyruar të dhënat për të dënuarit me vendim përfundimtar.
- ☐ Për të krijuar një orientim më të saktë në të dhënat e mësipërme duhet të kemi të qartë që në rastet kur për një vepër penale kemi çështje dhe vepra të plotësuara me shifra të ndryshme nga zero dhe nuk ka të dënuar p.sh. neni 307/2, për këto çështje penale është vendosur (*pafajësi, pushim vendimi, moskompetencë, kthim për plotësim hetimesh ose ndryshim të kualifikimit ligjor*) dhe në rastet kur nuk kemi të plotësuar me shifra rubrikën çështje, por kemi të dënuar kemi (*ndryshim të kualifikimit*) p.sh. në nenin 285/a të Kodit Penal, të paraqitura në tabelën e mësipërme.

KUNDËRVAJTJET (Contraventions)

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
84	Kanosja (Threat)	209	213
89	Plagosja e lehtë me dashje (Non-serious intentional injury)	276	215
90	Dëmtime të tjera me dashje (Other intentional harm)	368	83
91	Plagosja e rëndë nga pakujdesia (Serious injury due to negligence)	1	1
97	Mosdhënia ndihmë (Lack of help)	1	1
107	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike (Intercourse in public places)	1	0
110/1	Heqja e paligjshme e lirisë (Unlawful detention)	6	3
112	Dhunimi i banesës (Breaking and entering into someone's house)	30	16
119	Fyerja (Insulting)	73	11
120	Shpifja (Libel)	21	1
125	Mosdhënia e mjeteve për jetesë (Denial of support)	52	14
126	Mosnjohimi i ndryshimit të vendbanimit (Denying to inform on the changing of domicile)	3	4
127	Marrja e pa drejtë e fëmijës (Unlawfully taking the child)	24	5
130	Shtrengimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (Forcing or impeding to cohabit or divorce)	3	2
137/1	Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike (Stealing electrical power or telephone lines)	148	285
148	Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet (Publication of another persons work with own name)	3	0
157	Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes (Destroying the watering system)	1	1
159/2	Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit (Destroying water-supply system)	21	21
170/a	Punësim i paligjshëm (Illegal employment)	1	1

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
179/a	Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë Refusal to declare to border control currency and objects of value	5	6
180	Fshehja e të ardhurave (Concealment of income)	1	1
191/1	Falsifikimi i akteve të gjendjes civile (Falsifying acts of civil records)	17	32
192	Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve (Production of devices to falsify documents)	2	2
197	Organizimi i lotarive të palejuara (Organizing unlawful lotteries)	22	23
198	Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara (Providing the premises for unlawful gambling)	1	1
199	Shpërdorimi i tokës (Misuse of land)	5	5
200	Pushtimi i tokës (Unlawfully taking land)	20	18
201/1	Ndotja e ajrit (Polluting the air)	4	4
204	Peshkimi i ndaluar (Prohibited fishing)	12	20
205	Prerja e paligjshme e pyjeve (Unlawfully cutting forests)	124	111
206	Prerja e drurëve dekorativë e frutorë (Cutting decoration and fruit trees)	1	2
235/1	Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose shërbim publik (Opposing the public official)	17	17
236/1	Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik (Opposing the official of the public order police)	91	60
238	Kanosja për shkak të detyrës (Threatening a public official on duty)	14	17
239	Fyerja për shkak të detyrës (Insulting a public official on duty)	57	36
240	Shpifja për shkak të detyrës (Defamation toward a public official on duty)	13	8
242	Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik (Disobeying orders of the official of public order police)	48	55
245/1,1	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike (Exercise of the impact of illegal people exercising public functions)	2	5
246/1	Përvetësimi i titullit apo detyrës (Appropriating a public title or office)	1	3
247/1	Mbajtja pa të drejtë e uniformës (Unlawfully wearing a uniform)	1	1
249	Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij (Acting in a capacity after its termination)	5	6

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
257/a1	Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë Refusal to declare, concealment or fictive declaration of wealth of electives and civil servants.	6	9
272	Njoftimi i remë në organet e rendit (False information of public order)	4	3
273	Largimi nga vendi i aksidentit (Leaving the scene of an accident)	53	52
274	Prishja e qetësisë publike (Breach of public peace)	57	71
275	Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (Wrongful intentional use of telephone calls)	29	18
277	Vetëgjyqësia (Self-made justice)	50	61
278/3	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e municionit luftarak (Illegal manufacturing and keeping military weapons and ammunition)	26	37
280	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive (Illegally manufacturing and keeping hunting and sporting rifles)	49	52
288/a/1	Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë (Illegal producing of industrial and food products)	8	8
291	Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi (Driving while inebriated or without a license)	267	274
297	Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror (Illegally crossing state border)	162	215
305/a1	Deklaratat e rreme përpara prokurorit (False statements before the prosecutor)	0	5
305/b1	Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore (False statements before the judicial police officer)	3	3
306/1	Dëshmia e rreme (Perjury)	11	11
307/1	Refuzimi për të dëshmuar (Refusing to testify)	2	2
311	Kanosja për të mos kallëzuar (Threat to remain silent)	1	1
318	Fyerja e gjyqtarit (Insulting a judge)	5	2
320	Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës (Preventing the enforcement of court decisions)	33	25
320/a1	Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës Refusal to enforce a court decision without lawful reasons	1	0
321	Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës (Acts opposing court's decision)	1	1

Neni (Article)	Figura e veprës penale (Criminal acts)	Çështje (Cases)	Dënuar (Convicts)
Ligji nr.8663	Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT Law 8663 "On the registration, classification, way of using and checking of engine watercrafts, with weight of less than 20 tons"	2	1
Ligji nr.9669	"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" Law 9669 "On measures against violence in family relations"	1	0
Ligji nr.9662	"Për bankat në Republikën e Shqipërisë" Law 9662 "On banks in the Republic of Albania"	67	74
Të tjera	Others	20	18
TOTALI PËR KUNDËRVAJTJET		2563	2253
TOTALI PËR KRIME		4786	5349
TOTALI PËR KRIME & KUNDËRVAJTJE		7349	7602

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE ME VENDIME GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

(Way of termination for criminal cases with judgements which are terminated)

MËNYRA E PËRFUNDIMIT PËR TË GJITHA ÇËSHTJET PENALE

(Way of termination for all criminal cases)

☐ Me vendim fajësie	6739
☐ Me vendim pafajësie	262
☐ Vendosur pushimi i çështjes	665
☐ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	160
☐ Vendosur moskompetenca	55

T O T A L I	7881
--------------------	-------------

ÇËSHTJE TË GJYKUARA SIPAS KODIT PENAL

☐ Me vendim fajësie	6233
☐ Me vendim pafajësie	257
☐ Vendosur pushimi i çështjes	661
☐ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	157
☐ Vendosur moskompetenca	41

T O T A L I	7349
--------------------	-------------

ÇËSHTJE TË GJYKUARA SIPAS KODIT PENAL USHTARAK

☐ Me vendim fajësie	506
☐ Me vendim pafajësie	5
☐ Vendosur pushimi i çështjes	4
☐ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	3
☐ Vendosur moskompetenca	14

T O T A L I	532
--------------------	------------

KLASIFIKIMI I TË DËNUARVE PËR KRIME SIPAS GRUP VEPRASH PENALE (Classification of convicts for crimes committed, according to relevant groups of criminal offences)

TË DËNUAR (Convicts)

Grup veprash penale	Çështje penale	Të dënuar
Krime kundër jetës (Crimes against life)	242	245
Krime kundër shëndetit (Crimes against health)	96	96
Krime seksuale (Sexual offences)	38	33
Krime kundër lirisë së personit (Criminal acts against person's freedom)	25	41
Krime kundër moralit, dinjitetit dhe familjes (Criminal acts against morality, dignity and family)	126	146
Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (Criminal acts related to property or in the economic area)	2637	2906
Krime kundër autoritetit të shtetit & Krime kundër rendit dhe sigurisë publike (Criminal acts against public order and security)	1460	1646
Krime kundër drejtësisë (Criminal acts against justice)	109	191
Krime të tjera (Other Criminal acts)	52	45

Gjatë vitit 2008 janë dënuar gjithsej **8105** persona, ku **7602** janë dënuar sipas Kodit Penal dhe **503** të dënuar sipas Kodit Penal Ushtarak.

Në vijim po analizojmë të dënuarit sipas Kodit Penal.

Nga **8833** të gjykuar gjithsej **7602** ose **86%** e tyre janë të dënuar, **353** ose **3.98 %** janë persona të cilët janë deklaruar të pafajshëm dhe për **878** ose **9.9 %** e tyre është pushuar gjykimi i çështjes.

Nga **7602** të dënuar gjithsej, për krime janë dënuar **5349** ose **70.36 %**, kurse për kundërvajtje penale **2253** ose **29.6 %**.

Janë deklaruar të pafajshëm **353** persona ose **3.98 %** e numrit total të të gjykuarve ku **247** për krime dhe **106** për kundërvajtje penale.

Është pushuar gjykimi për **878** ose për rreth **9.9 %** e numrit total të gjykuarve, nga të cilët **192** janë gjykuar për krime dhe **686** për kundërvajtje penale.

Nga të dënuarit **557** ose **7.3 %** janë të dënuara femra, ku **361** janë dënuar për krime dhe **196** për kundërvajtje. Të dënuar të mitur janë **407** ose **5.3 %** të të dënuarve, ku **356** janë dënuar për krime dhe **51** të dënuar për kundërvajtje penale.

Duke analizuar të dënuarit sipas grupveprave penale për krime arrihet në përfundimin se numrin më të madh të të dënuarve e përbëjnë ata që kanë konsumuar veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike që përbëjnë **59.97 %** të të gjithë të dënuarve për krime. Të dënuarit për krime kundër autoritetit të shtetit & rendit dhe sigurisë publike përbëjnë **31.3 %**, e kështu me radhë renditen të dënuarit për krime kundër jetës me **4.67%**, kundër drejtësisë me **3.7 %**, kundër moralit, dinjitetit dhe familjes etj.

Po të analizohet problemi në fjalë në lidhje me intensitetin e të dënuarve lidhur me numrin e veprave penale që përmban grupimi i mësipërm d.m.th. **mesataren e të dënuarve për çdo krim**, situata e mësipërme krijon një panoramë të tillë ku të dënuarit **për krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** janë në vendin e parë me **51** të dënuar për çdo krim, të dënuarit **për krime kundër autoritetit të shtetit & krime kundër rendit dhe sigurisë publike** me **20** të dënuar për çdo krim, të dënuar **për krime kundër jetës me 13 të dënuar për çdo krim**, grupime këto të cilat do të përbënin **modën** për të dënuarit. Gjithashtu numri i të dënuarve për krime kundër shtetit dhe krimet kundër moralit, dinjitetit dhe familjes është i njëjtë me 6 të dënuar për çdo krim.

Për grupime të tjera të veprave penale kemi :

- ☐ Për krimet kundër drejtësisë **8** të dënuar për krim, për krimet seksuale **4** të dënuar për krim, për krimet kundër lirisë së personit **3** të dënuar për çdo krim.

Po të analizojmë problemin e mësipërm në pikëpamje të grupimit për masë dënimi për vitin 2008 rezulton se të dënuar me gjobë (krime dhe kundërvajtje) janë **2897** ose **38.1 %** e të gjithë të dënuarve në krahasim me **1847** ose **35.2 %** që kishim në vitin 2007. Të dënuar deri në 2 vjet burg janë **3650** ose **48 %** të dënuar në krahasim me **2980** ose **52.4 %** që kishim në vitin 2007, në intervalin 2 – 5 vjet janë **512** ose **6.7 %** e të gjithë të dënuarve në krahasim me **430** ose **7.9 %** të dënuar që kishim në vitin 2007, në intervalin 5 – 10 vjet janë **320** ose **4.2 %** të dënuar në krahasim me **246** të dënuar ose **3.7 %**, që kishim në vitin 2007, në intervalin 10 – 25 vjet janë **210** ose **2.7 %** e të gjithë të dënuarve në krahasim me **170** të dënuar ose **3.3 %** që kishim në vitin 2007 dhe me burgim të përjetshëm **13** ose pothuajse **0.02%** e të gjithë të dënuarve në krahasim me **5** ose **0.3 %** të dënuar që kishim në vitin 2007.

Në mënyrë tabelare situata e mësipërme paraqitet:

Periudha (Period)	Të dënuar	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)	Burgim i përjetshëm (Life imprisonment)
Viti (Year) 2007	5678	1847	2980	430	246	170	5
Viti (Year) 2008	7602	2897	3650	510	320	210	13

Pra në krahasim me vitin 2007, në vitin 2008 vihet re një zmadhim i numrit të të dënuarve me gjobë me **1050** të dënuar, rritje të numrit të të dënuarve me masë dënimi deri 2 vjet burg me **607** të dënuar, rritje të numrit të të dënuarve me masë dënimi 2 deri 5 vjet prej **80** të dënuar, rritje të numrit të të dënuarve me masë dënimi 5 - 10 vjet burg prej **74** të dënuar, me masë dënimi 10 - 25 vjet burg me **40** të dënuar më shumë se një vit më parë dhe rritje të ndjeshme e numrit të dënuarve prej **9** të dënuar me masën e dënimit burgim i përjetshëm në krahasim me vitin 2007. Në këtë rritje të numrit të masave të dënimit (si numër jo si sanksion), duhet të kemi parasysh se numri i të dënuarve për këtë vit ka qenë **1924** të dënuar më shumë se një vit më parë.

Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme konkludohet që **moda** e të dënuarve sipas intensitetit është për **klasat krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**. Sipas volumit të të dënuarve kemi në modë të dënuarit për krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, kjo edhe për numrin e madh të veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal.

- **Moda** për masën e dënimit edhe për vitin 2008 është **dënimi deri 2 vite burg me 3650** dënime.

Nga **7602** të dënuar në përgjithësi, kemi **356** të dënuar **të mitur** për krime dhe **51** të dënuar për kundërvajtje **që në total** përbëjnë **407** të dënuar dhe që zënë **5.3 %** të dënuarve në shkallë vendi. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë numri i të dënuarve të mitur është rritur me **196** të dënuar më shumë ose me **1.5%** më shumë.

Gjatë dy viteve të fundit rezulton se numri i të dënuarve të mitur ka ardhur duke u rritur gradualisht.

Duke evidentuar të dënuarit sipas seksit arrihet në përfundimin se nga **7602** të dënuar, **557** prej tyre janë **femra** ku **361** janë dënuar për krime dhe **197** për kundërvajtje dhe që zënë përafërsisht **7%** të të gjithë të dënuarve, krahasuar me vitin 2007 kemi një rënie të vogël të numrit të femrave të dënuara, i cili ka qenë **8%**.

Duke u nisur nga raporti i numrit të femrave në shoqëri ky numër është i vogël dhe megjithëse kemi një rënie të numrit të të dënuarve femra në krahasim me vitet paraardhëse **63** të dënuara më pak se në vitin 2005, **24** të dënuara më pak se në vitin 2006, dhe **102** të dënuara më shumë se në vitin 2007 ky fenomen kërkon vëmendje të posaçme. Nga statistikatat vihet re se edhe pse numri i të dënuarve femra është në rritje krahasuar me vitet paraardhëse, ky numër është në nivele minimale krahasuar me numrin e të dënuarve meshkuj.

Krahasuar me të dënuarit në vitin 2007 janë **1924** të dënuar më shumë, ose e shprehur në përqindje kemi **16.4 %** të dënuar për krime & kundërvajtje më shumë se vitin 2007, por nëse marrim në konsideratë faktin se numri i çështjeve penale të përfunduara për krime dhe kundërvajtje është i njëjtë me atë të vitit 2007 (ndryshon me një çështje më shumë **7348**), mund të themi se numri i të dënuarve ka pësuar një rritje në **7602** për **7349** çështje penale të përfunduara në vitin 2008, ndërsa numri i çështjeve të përfunduara nga **6268** me **5678** të dënuar në vitin 2007.

Duke e krahasuar me vitin 2007, në vitin 2008 përsa i përket klasifikimit të të dënuarve për krimet e kryera kundër jetës ky numër ka pësuar një rritje prej **250** të dënuarish.


Për krimet e kryera kundër shëndetit, në krahasim me vitin 2007 kemi një rritje me **22** të dënuar më shumë për vitin 2008, po ashtu lidhur me numrin e të dënuarve për krime seksuale kemi një rritje me vetëm **1** të dënuar më shumë, lidhur me krime kundër lirisë së personit kemi **29** të dënuar më shumë, lidhur me krime kundër moralit familjes dhe dinjitetit kemi **37** të dënuar më shumë. Ndërsa për krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me **655** të dënuar në krahasim me vitin 2007.

Për numrin e të dënuarve për krime kundër autoritetit të shtetit dhe krime kundër rendit dhe sigurisë publike kemi një rritje prej **296** të dënuar më shumë. Përsa i përket krimeve kundër drejtësisë evidentojmë se ky numër ka pësuar një rritje prej **65** të dënuarish në krahasim me vitin 2007. Gjithashtu kemi rritje të numrit të të dënuarve me **45** të dënuar më shumë për krime të tjera.

PERSONAT E GJYKUAR DHE LLOJI I VENDIMEVE TË DHËNA NDAJ TYRE (Tried persons and the type of rulings imposed against them)


Me vendime përfundimtare për vepra penale të ndryshme sipas Kodit Penal (Civil) janë gjykuar **8833** persona prej të cilëve :

□ Janë dënuar	7602
□ Janë deklaruar të pafajshëm	353
□ Është vendosur pushimi i çështjes	878
T O T A L I	8833



PERSONAT E DËNUAR SIPAS RRETHEVE GJYQËSORE
(Persons convicted according to district courts)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Të gjykuar (Tried persons)	Të dënuar (Convicted)	Të pafajshëm (Not guilty)	Të pushuar (Ceased)	Të dënuar të mitur (Juvenile convicts)
Berat	378	322	9	47	1
Dibër	165	143	13	9	0
Durrës	912	806	21	85	169
Elbasan	587	435	17	135	0
Fier	570	483	20	67	0
Gjirokastrë	336	260	29	47	28
Kavajë	176	162	1	13	0
Korçë	608	527	24	57	90
Krujë	142	120	6	16	0
Kukës	157	132	9	16	0
Kurbin	211	186	9	16	0
Lezhë	249	224	13	12	0
Lushnjë	235	176	7	52	1
Mat	100	82	8	10	0
Pogradec	191	132	23	36	0
Pukë	84	42	7	35	0
Sarandë	148	110	6	32	0
Shkodër	620	563	35	22	50
Tiranë	2083	1903	65	115	48
Tropojë	144	112	5	27	0
Vlorë	583	533	23	27	20
Krimet e Rënda	154	149	3	2	0
T O T A L I	8833	7602	353	878	407



TË DËNUARIT, VEPRA KRYESORE PËR TË CILËN ËSHTË DËNUAR DHE MASA E DËNIMIT
(Offenders, main offences for which they are sentenced and sentence term)

Neni (Article)	MASA E DËNIMIT (Sentence Term)					
	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)	Burgim i përhjetshëm (Life imprisonment)
76	1	6	13	37	39	0
77	0	0	0	0	2	0
78/1	0	4	5	9	44	2
78/2	0	0	0	2	13	0
79	0	0	2	0	24	3
79/a	0	0	0	0	1	0
79/b	0	0	0	0	1	1
79/c	0	0	0	1	8	3
79/dh	0	0	0	0	8	0
82	0	3	3	1	0	0
83	0	0	0	1	0	0
85	0	4	4	0	0	0
88	0	22	30	7	1	0
88/a	2	8	9	2	0	0
88/b	0	5	2	1	0	0
96	2	0	0	0	0	0
99	2	2	1	0	0	0
100/(1)	0	1	4	4	0	0
100/(2)	0	0	0	1	5	0
101/1,2	0	0	4	1	0	0
102	0	3	2	2	0	0
108	0	4	2	0	0	0
109/(1)	0	0	0	0	6	1
109/(2),(3)	0	0	0	2	1	0
109/a	0	0	2	2	0	1
109/b	0	0	2	1	0	0
110/(2)	0	11	12	0	0	0
113	13	40	0	0	0	0
114	3	6	2	0	0	0
114/a	0	2	6	12	5	0
114/a (1)	0	0	0	6	1	0
114a (2)	0	0	0	1	0	0
114/a (4)	0	0	0	2	0	0
114/b(1)	0	0	2	0	0	0
114/b(2)	1	0	0	3	6	0
114/b(3)	0	0	0	0	3	0
115	0	2	2	0	0	0
118	4	6	0	0	0	0
124	1	4	0	0	0	0

Neni (Article)	MASA E DËNIMIT (Sentence Term)					
	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)	Burgim i përjetshëm (Life imprisonment)
128/b1	0	0	2	0	0	0
128/b3	0	0	0	0	1	0
128/b4	0	0	0	1	0	0
134/1	11	608	4	0	0	0
134/2	11	727	34	1	3	0
134/3	0	4	1	6	0	0
135	0	26	4	0	0	0
136	1	0	0	1	0	0
137/2	19	4	0	0	0	0
139	0	13	35	22	1	0
140	0	1	4	20	7	0
141	0	0	0	0	4	2
141/a	0	3	10	1	0	0
141/a(2)	0	0	2	1	0	0
142	2	1	0	0	0	0
143	71	65	22	8	1	0
143/a	2	1	9	0	0	0
145	8	0	0	0	0	0
146	1	7	0	0	0	0
150	52	11	0	0	0	0
151	12	22	1	0	0	0
152	3	7	0	0	0	0
154	0	1	0	0	0	0
159/1	0	9	0	0	0	0
161	3	3	0	0	0	0
164/b	0	1	0	0	0	0
172	8	0	0	0	0	0
173	1	0	0	0	0	0
174	35	20	0	0	0	0
175	0	0	1	0	0	0
177	3	1	0	0	0	0
178	48	14	0	0	0	0
179	14	1	0	0	0	0
181	18	3	1	0	0	0
181/a2	1	0	0	0	0	0
183	1	10	8	0	0	0
184	2	0	0	0	0	0
186	78	208	4	2	3	0
187	47	21	0	0	0	0
189	54	218	3	0	0	0
190	7	110	2	0	0	0
191/2,3	10	28	2	0	0	0
192/a	4	0	0	0	0	0
192/b	1	0	0	0	0	0

Neni (Article)	MASA E DËNIMIT (Sentence Term)					
	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)	Burgim i përjetshëm (Life imprisonment)
227	2	1	0	0	0	0
235/2	6	4	0	0	0	0
236/2	71	53	1	1	0	0
237	62	41	0	0	0	0
244	3	5	0	0	0	0
245	1	0	2	0	0	0
246/2	0	3	0	0	0	0
248	23	55	3	0	0	0
250	10	1	0	0	0	0
257	2	0	0	0	0	0
257/a2	2	0	0	0	0	0
258	23	3	0	0	0	0
259	6	11	5	0	0	0
260	0	1	0	0	0	0
278/1	3	15	1	0	0	0
278/2	65	281	10	7	1	0
278/4	2	1	0	1	0	0
278/a	0	2	0	0	0	0
279	19	20	0	0	0	0
282/a	0	0	2	1	0	0
283	0	1	6	29	1	0
283/(1)	1	7	98	21	1	0
283/(2)	0	2	16	34	7	0
283/a(1)	0	0	1	3	0	0
283/a(2)	0	1	2	30	9	0
283/a(3)	0	0	0	0	1	0
283/b	0	1	0	0	0	0
284	1	3	17	1	0	0
284/(1)	0	5	15	0	0	0
284/a	0	0	0	0	1	0
285	0	0	2	1	0	0
285/a	0	1	0	0	0	0
287	0	1	0	0	0	0
287/a	0	1	0	0	0	0
287/b	0	5	0	0	0	0
288	1	0	0	0	0	0
288/a(2)	3	1	0	0	0	0
289	3	6	1	0	0	0
290	113	190	17	6	0	0

Neni (Article)	MASA E DËNIMIT (Sentence Term)					
	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)	Burgim i përjetshëm (Life imprisonment)
293	12	0	0	0	0	0
298	2	31	18	2	0	0
298/(1)	5	19	0	0	0	0
298/(2)	0	12	20	0	0	0
298/(3)	0	2	13	14	0	0
300	31	46	1	0	0	0
301	7	8	0	0	0	0
302	3	10	0	0	0	0
303	0	0	1	0	0	0
305	48	18	0	0	0	0
306/2	2	2	0	0	0	0
316	1	1	0	0	0	0
317	0	1	0	0	0	0
323	1	9	1	0	0	0
326	1	1	0	1	0	0
Ligji nr. 9662	4	2	0	0	0	0
Ligji nr. 9669	32	1	0	0	0	0
SHUMA	1128	3166	512	320	210	13

MASA E DËNIMIT (Sentence Term)		
Neni (Article)	Dënim me gjobë (Fine)	Dënim deri 2 vite burg (up to 2 years)
84	118	95
89	156	59
90	71	12
91	0	1
97	1	0
110/1	2	1
112	16	0
119	10	1
120	0	1
125	8	6
126	1	3
127	4	1
130	0	2
137/(1)	229	56
157	1	0
159/2	16	5
170/a	1	0
179/a	5	1
180	1	0
191/1	8	24
192	0	2
197	23	0
198	1	0
199	5	0
200	15	3
201/1	4	0
204	14	6
205	97	14
206	2	0
235/1	15	2
236/1	51	8
238	10	7
239	32	4
240	8	1
242	44	11
245/1,1	1	4
246/1	3	0
247/1	1	0

MASA E DËNIMIT (Sentence Term)		
Neni (Article)	Dënim me gjobë (Fine)	Dënim deri 2 vite burg (up to 2 years)
249	5	1
257/a(1)	9	0
272	3	0
273	47	6
274	57	14
275	15	3
277	50	11
278/3	19	18
280	46	6
288/a(1)	6	2
291	244	30
297	182	33
305/a(1)	5	0
305/b(1)	2	1
306/1	7	4
307/1	2	0
311	0	1
318	1	1
320	22	3
321	0	1
Ligji nr. 8663	1	0
Ligji nr. 9662	62	12
Të tjera	10	8
SHUMA KV	1769	484
TOTALI	2897	3650

DISA NGA RIKUALIFIKIMET E VEPRAVE PENALE

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga neni 76 i KP që ka ardhur nga prokuroria, tek nenet 278/(2) dhe 84 të KP, ky cilësim ka bërë që i dënuari të jetë shënuar për veprën e nenit 278/(2) të KP.

Për nenin 142 të KP është pasqyruar 1 i dënuar më pak se numri i çështjeve, pasi 1 i dënuar ka pasur 2 çështje për nenin 142 të KP dhe gjykata i ka bashkuar të dyja çështjet në një të vetme.

Për nenin 143 KP për një person të gjykuar është vendosur “Moskompetencë”

Për nenin 323 të Kodit Penal (KP) për një person të gjykuar është vendosur moskompetencë dhe për një person të gjykuar është vendosur “Kthim aktesh prokurorisë”.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për nenin 76 të KP për 2 çështje ka vendosur mjekim të detyruar, po ashtu edhe për një çështje është vendosur rrëzimi i kërkesës për mjekim të detyrueshëm.

Për nenin 78 është vendosur një mjekim i detyruar

Për nenin 134/(1) është vendosur përjashtim nga dënimi.

Për nenin 134/(2) është vendosur një çështje është përjashtuar nga dënimi.

Për neni 151/(1) për një çështje është vendosur mjekim i detyruar.

Për neni 189 është vendosur mospranimi i kërkesës për caktim mase.

Për nenin 248 është rrëzuar kërkesa për caktim mase.

Për nenin 267 është pranuar vlerësimi i masës.

Për nenin 274 për një çështje është vendosur mjekim i detyruar.

Për nenin 278/(2) dy kërkesa për masë sigurimi janë rrëzuar.

Për nenin 284/(1) për një çështje është vendosur mjekim i detyruar.

Për nenin 286 është vendosur mospranimi i kërkesës për caktim mase.

Për nenin 298/(3) është vendosur mospranimi i kërkesës për caktim mase.

4 çështje tek masat e sigurimit janë me objekt “Letër porosi”.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për një çështje të ardhur për nenin 78 ka vendosur shtrim të detyrueshëm në spital psikiatrik.

Për një çështje të nenit 88 të KP është bërë rikualifikim në nenin 89 të KP.

Po ashtu kjo gjykatë ka vendosur krahas dënimit me burg, është aplikuar dënimi me gjobë për 2 çështje të nenit 186 të KP, për një çështje të nenit 189 të KP, për një çështje të nenit 190 të KP dhe për një çështje të nenit 298/2 të KP.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat

Ka pasur ndryshim të cilësimit juridik për një çështje të nenit 101/(1) të KP tek neni 108 të KP.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka pasur këto cilësime juridike:

Për nenin 76 një çështje është pushuar, pasi është caktuar masë mjekësore për papërgjegjshmëri të të pandehurit.

Për nenin 84 kemi 3 çështje të ardhura mbi ankimin e palës.

Për nenin 90 kemi gjashtë çështje të ardhura mbi ankimin e palës.

Për nenin 112 kemi një çështje të ardhur mbi ankimin e palës.

Për nenin 119 kemi 2 çështje të ardhura mbi ankimin e palës.

Për nenin 125 kemi 10 çështje të ardhura mbi ankimin e palës.

Për nenin 148 kemi një çështje të ardhur mbi ankimin a palës.

Për nenin 127 kemi një çështje të ardhur mbi anikimin e palës.

Po ashtu tek ankimet nuk janë përfshirë 15 arreste, 15 kërkesa të tjera penale, një ankim nga e dëmtuara akuzuese.

Për nenin 274 për një të pandehur i janë kthyer aktet prokurorisë.

Për nenin 186 për 2 të pandehur i janë kthyer aktet prokurorisë.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë

Për veprën penale të parashikuar në nenin 189 të KP është gjykuar një person dhe është dënuar me burgim deri në 2 vjet dhe gjobë.

Për veprën penale të parashikuar në nenin 134/(1) të KP janë gjykuar 3 persona nga të cilët 2 janë dënuar me burgim në 10 vjet për një është dhënë vendim pafajësie.

Për veprën penale të parashikuar në nenin 291 të KP janë gjykuar katër persona, për të cilët në tre raste është dhënë dënim me gjobë dhe në një rast dënim me burgim deri në 2 vjet.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i KP janë gjykuar 5 çështje me 7 persona dhe për të gjithë është vendosur pushimi i gjykimit.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Për nenin 76 është ndryshuar akuza në katër raste, 2 raste për nenin 84, një rast për nenin 303 dhe një rast për nenin 88/(1).

Për nenin 78/(1) është ndryshuar akuza në pesë raste, 2 për nenin 88, një rast për nenin 84, një rast për nenin 280 dhe një rast për nenin 278/(2).

Për nenin 79 është ndryshuar akuza në nenin 84.

❑ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë

Për nenin 76 të KP për një çështje është bërë rikualifikim i veprës tek neni 83 i KP.

Për nenin 84/b të KP të vjetër e cila parashikon vrasjen e dy personave për këtë çështje është e vendosur si çështje për nenin 79/dh.

Për nenin 84 të KP është bërë rikualifikim i kundërvajtjes penale tek neni 275 i KP.

Citimet e mësipërme janë bërë nga kancelarët e gjykatave të rretheve gjyqësore përkatëse.

KREU III

- ❖ **SHPËRNDARJA E KRIMINALITETIT
GJATË VITIT 2008 BAZUAR NË ÇËSHTJET
PENALE TË PËRFUNDUARA**

SHPËRNDARJA E KRIMINALITETIT GJATË VITIT 2008 BAZUAR NË ÇËSHTJET PENALE TË PËRFUNDUARA (Distribution of Criminality Rate for 2008 According to Completed Criminal Cases)

Koeficienti i kriminalitetit është një parametër që mat kriminalitetin në një mjedis të caktuar në raport me popullsinë e atij mjedisi, pra tregon shkallën e konsumimit të veprave penale (krimeve ose kundërvajtjeve) duke e vendosur këtë të dhënë përballë numrit të personave. Si rregull ai shpreh numrin e krimeve për 100.000 banorë.

Nga studimi i kryer për të dhënat e çështjeve penale të përfunduara (krime dhe vepra penale në tërësi) rezulton **që për vitin 2008 në shkallë vendi kemi 148 krime për 100.000 banorë.**

Kriminaliteti sipas këtij koeficienti e ndan territorin e Shqipërisë në tre grupe kryesore:

GRUPI I

- Kriminalitet më të lartë se mesatarja (148 – 360 krime për 100 000 banorë) kemi në rrethet **Durrës, Korçë, Krujë, Gjirokastrë, Kurbin, Shkodër, Tiranë, Tropojë dhe Vlorë.**

GRUPI II

- Kriminalitet që në koeficient është i përafërt me mesataren e vendit (100 – 148 krime për 100.000 banorë) ka në rrethet **Dibër, Fier, Kavajë, Krujë, Lezhë, Mat, Pogradec dhe Sarandë.**

GRUPI III

- Kriminalitet me vlera nën mesataren e vendit (67 – 99 krime për 100.000 banorë) kemi në rrethet **Berat, Elbasan, Kukës, Lushnjë dhe Pukë.**

Maksimumi dhe minimumi i kriminalitetit në vend janë :

Maksimumi Tropojë, Vlorë, Durrës, Kurbin dhe Tiranë, ndërsa minimumi, Elbasan, Lushnjë dhe Kukës

Gjithashtu amplituda e këtij kriminaliteti është relativisht e madhe, d.m.th. raporti i koeficientit më të lartë të kriminalitetit me atë më të ulët është 5 me 1. Amplituda është më e ulët se në vitin 2007, ku ka qenë 8 me 1, amplituda më e ulët se në vitin 2006 ku ishte 10 me 1, amplituda më e ulët se në vitin 2005 ku ishte 12 me 1 dhe amplituda më e ulët se në vitin 2004 ku ishte 8 me 1.

Për vitin 2008 në krahasim me vitet e mëparshme raporti i koeficientit më të lartë të kriminalitetit me atë më të ulët është ngushtuar.

Po të bëjmë krahasimin me vitet 2002, 2003, 2004, vitin 2005 dhe vitin 2006 **kriminaliteti në vend është ulur**, por në krahasim me vitin 2007, ky koeficient në shkallë vendi ka pësuar rritje.

Kështu koeficienti i kriminalitetit nga **113** krime për 100.000 banorë në vitin 2002; **131** krime për 100.000 banorë në vitin 2003; **136** krime për 100.000 banorë në vitin 2004; **129** krime për 100.000 banorë në vitin 2005, **142** krime për 100.000 banorë në vitin 2006; **129** është krime për 100.000 banorë në vitin 2007 dhe **148** është krime për 100.000 banorë në vitin 2008. Shohim se në vitin 2006 dhe vitin 2008 kemi koeficient kriminaliteti afërsisht të njëjtë .

Edhe koeficienti për vepra penale (krime + kundërvajtje) paraqet variacionin e vlerave absolute të çështjeve penale të gjykuara nga **157** në vitin 2002 në **184** gjatë vitit 2003; **208** në vitin

2004; **193** çështje të gjykuara për çdo 100.000 banorë në vitin 2005, **205** çështje të gjykuara për çdo 100.000 banorë në vitin 2006; **197** çështje të gjykuara për çdo 100.000 banorë në vitin 2007 dhe **228** çështje të gjykuara për çdo 100.000 banorë në vitin 2008.

Për rrethe të tilla, si **Durrësi, Vlora, Tirana dhe Gjirokastra** një nga faktorët që ndikon në rritjen e kriminalitetit është edhe eksportimi i krimit për arsye të pozicionit të tyre gjeografik, pasi disa nga veprat penale të kryera, si p.sh. trafiket, kalime të paligjshme të kufirit janë kryer nga banorë me banim jashtë këtyre rretheve.

Vëmendje të veçantë paraqet edhe analiza e llojit të veprave penale që konsumohen dhe për të cilat gjykatat japin vendim përfundimtar.

Në këtë këndvështrim krimin më të ashpër e ndeshim në rrethet: Durrës, Gjirokastrë, Kurbin Tropojë dhe Tiranë ku mbi 50 % e tyre janë krime kundër jetës; krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Gjithashtu disproporcion kemi edhe në raportin krime kundërvajtje, p.sh. në rrethin e Durrësit nga **725** çështje të gjykuara **551** janë për krime dhe **210** kundërvajtje, pra **76 %** janë krime; në rrethin e Gjirokastrës nga **317** çështje të gjykuara **187** janë për krime dhe **130** kundërvajtje, pra **59 %** janë krime, ndërsa në rrethin e Tiranës nga **1732** çështje të gjykuara **1324** janë për krime dhe **408** kundërvajtje, pra **76%** janë krime; në rrethin Fier nga **461** çështje të gjykuara, **325** janë gjykuar për krime dhe **136** për kundërvajtje ose **70 %** e tyre janë krime. Kjo dukuri vërehet edhe për vitet e kaluara.

Për llojin dhe strukturën e krimit të përhapur në shkallë vendi më shumë ndihmojnë të dhënat analitike të nxjerra për çdo rreth gjyqësor dhe që pasqyrohen në kapitull të veçantë.

Në përlogaritjen e koeficientit të kriminalitetit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare për numrin e popullsisë të marra nga INSTAT dhe që i referohen vitit 2008. Meqenëse nuk kemi parasysh çështjet penale ushtarake, si dhe çështjet e gjykuara nga Gjykata e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2008, atëherë edhe **ritmet e rritjes së popullsisë apo të lëvizjes së saj** kompensohen dhe pretendohet për një studim të këtij fenomeni me saktësi të lartë.


Në numrin total 3 177 385 të popullsisë janë llogaritur dhe rrethet që nuk kanë një gjykatë, por që çështjet e tyre gjykohen nga gjykatat e rretheve gjyqësore të mësipërme p.sh. popullsia e Shkodrës është **186 958** dhe popullsia e Malësisë së Madhe **36 645**, ku shtrin veprimtarinë rrethi gjyqësor Shkodër, për këtë arsye në tabelën e koeficientit të kriminalitetit **numri i popullsisë së rrethit Shkodrës është 223 603. Po kështu është vepruar me 20 gjykatat e tjera që kanë kompetenca tokësore dhe shtrijnë veprimtarinë e tyre në rrethet që nuk kanë një gjykatë si p.sh. në rrethet Has, Bulqizë, Kuçovë etj.**

STUDIMI I KOEFICIENTIT TË KRIMINALITETIT (Study of the criminality rate)

Tepelenë	12	0	12	5	7	0	3	0	0	1	0	1
Tiranë	196	170	366	101	265	0	82	1	0	9	3	1
Tropojë	0	11	11	8	3	0	6	0	0	1	0	1
Vlorë	68	48	116	71	45	0	55	0	0	12	0	2
TOTALI	863	846	1709	544	1165	0	413	7	0	70	12	17
Krimet e rënda (rrethi)	43	50	93	39	54	0	23	1	0	4	6	4
Kr. Renda Apel	1	16	17	1	16	0	0	0	0	1	0	0
TOTALI	907	912	1819	584	1235	0	436	8	0	7	18	42

GJYKATA E LARTË
(SUPREME COURT)
ÇËSHTJE PENALE
(CRIMINAL APPEALS)


Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Moskompetencë	Llojet e ndryshimeve (The kind of changes)			Afati i shqyrtimit (Term of examined)		
		Lidhur me dënimin (Concerning sentence)	Rikualifikim (Requalification)	Padia civile (Low suit)	Deri në 1 muaj (Up to 1 month)	1 - 2 muaj (1-2 months)	Mbi 2 muaj (Over 2 months)
Berat	1	0	0	0	18	1	0
Bulqizë	0	0	0	0	5	0	0
Dibër	3	0	0	0	11	0	0
Durrës	2	0	0	0	23	6	0
Elbasan	0	0	0	0	26	4	0
Fier	0	0	0	0	38	2	0
Gramsh	0	0	0	0	3	3	0
Gjirokastrë	1	0	0	0	11	4	0
Kavajë	0	0	0	0	10	1	0
Kolonjë	0	0	0	0	3	0	0
Korçë	1	0	0	0	23	3	0
Krujë	1	0	0	0	4	0	0
Kukës	0	0	0	0	6	0	0
Kurbin	0	0	0	0	16	1	0
Lezhë	2	0	0	0	27	0	0
Librazhd	0	0	0	0	2	0	0
Lushnjë	2	0	0	0	16	0	0
Mat	1	0	0	0	12	0	0
Mirditë	0	0	0	0	5	1	0
Përmet	0	0	0	0	1	0	0
Pogradec	1	0	0	0	7	0	0
Pukë	0	0	0	0	1	1	0
Sarandë	1	0	0	0	19	0	0
Shkodër	2	0	0	0	36	2	0
Skrapar	0	0	0	0	2	0	0
Tepelenë	0	0	0	0	5	0	0
Tiranë	5	0	0	0	88	13	0
Tropojë	0	0	0	0	8	0	0
Vlorë	2	0	0	0	66	5	0
TOTALI	25	0	0	0	497	47	0
Krimet e rënda (rrethi)	1	0	0	0	25	14	0
Kr. Rënda Apel	0	0	0	0	1	0	0
TOTALI	26	0	0	0	523	61	0

NUMRI I ÇËSHTJEVE PENALE TE SHQYRTUARA SIPAS RRETHEVE NGA GJYKATA E LARTE TË SHPREHURA NË %.

(Number of penal appeals examined by the Supreme Court according to District Courts in %)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Numri i çështjeve (Number of cases)	Përqindja (Percentage) (%)
Berat	19	3%
Bulqizë	5	1%
Dibër	11	2%
Durrës	34	6%
Elbasan	30	6%
Fier	40	7%
Gramsh	6	1%
Gjirokastër	15	3%
Kavajë	11	2%
Kolonjë	3	1%
Korçë	26	5%
Krujë	4	1%
Kukës	6	1%
Kurbin	17	3%
Lezhë	27	5%
Librazhd	2	0%
Lushnjë	16	3%
Mat	12	2%
Mirditë	6	1%
Përmet	1	0%
Pogradec	7	1%
Pukë	2	0%
Sarandë	19	3%
Shkodër	38	7%
Skrapar	2	0%
Tepelenë	5	1%
Tiranë	101	19%
Tropojë	8	1%
Vlorë	71	13%
T O T A L I	544	100%
Krimet e Renda(Rrethi)	39	-
Kr. Rënda Apel	1	-
T O T A L I	584	-

ÇËSHTJET PENALE TË SHQYRTUARA SIPAS RRETHEVE NGA GJYKATA E LARTË TË SHPREHURANË %



KREU IX

❖ ÇËSHJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË

(Civil cases examined by districts courts)

ÇËSHTJET CIVILE TË REGJISTRUARA PËR VITIN 2008

(Registered Civil cases for 2008)

LLOJI I ÇËSHTJEVE (The kind of Cases)	Gjithsej (Total)
A. PADI ME PALË KUNDËRSHTARE	
I. CIVILE NË PËRGJITHËSI	
Padi pronësie (Neni 149-231)	2753
Padi uzufukti (Neni 232-260)	1
Padi servituti (Neni 261-295)	73
Padi për kërkim sendi (Neni 296-303)	1474
Padi posedimore (Neni 304-315)	147
Padi trashëgimie (Neni 316-418)	238
Padi shkarkim dëmi (Neni 608-654)	1487
Padi begatim pa shkak (Neni 655-658)	67
Padi pagim i padetyruar (Neni 653-654)	26
Padi gjerimi i punëve të tjetrit (Neni 648-652)	0
Padi të kontratave të shitjes (Neni 705-756)	450
Padi pjesëtim sendi (Neni 207)	875
Padi kontrate shkëmbimi (Neni 757-760)	14
Padi kontrate dhurimi (Neni 761-771)	65
Padi kontrate furnizimi (Neni 772-783)	223
Padi kontrate emfiteoze (Neni 784-800)	8
Padi kontrate qiraje (Neni 801-849)	227
Padi kontrate sipërmarrje (Neni 850-876)	322
Padi kontrate transporti (Neni 877-900)	10
Padi kontrate huapërdorje (Neni 901-912)	13
Padi kontrate të përdorjes (Neni 913-934)	19
Padi kontrate komisioni (Neni 935-944)	1
Padi kontrate spedicioni (Neni 945-949)	1
Padi kontrate agjencie (Neni 950-961)	0
Padi për kalim pasurie (Neni 962-972)	55
Padi kontrate ndërmjetësimi (Neni 973-981)	2
Padi kontrate depozite (Neni 982-1012)	2
Padi kontrate llogari rrjedhëse (Neni 149-231)	0
Padi kontrate bankare (Neni 1024-1049)	5
Padi kontrate huaje (Neni 1050-1055)	666
Padi kontrate franchising (Neni 1056-1064)	2
Padi kontrate e rentës jetësore (Neni 1065-1073)	0
Padi kontrate shoqëri thjeshte (Neni 1074-1112)	7
Padi kontrate e sigurimit (Neni 1113-1161)	152
Padi të tjera kontraktuale	1176
Padi kundërshtim veprimi përmbarimor	979
Padi për marrëdhënie pune	1679
Kompensim për burgim të padrejtë	84
Te tjera	3978
SHUMA CIVILE	17281

II. ÇËSHTJE FAMILJARE	
Padi për zgjidhje martese	6109
Padi për pension ushqimor	218
Padi për njohje atësie	50
Padi për ç'njohje atësie	20
Të tjera	1685
SHUMA FAMILJARE	8082
III. ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE	
Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrativ	4990
Padi për refuzim miratimi akti administrativ	473
SHUMA ADMINISTRATIVE	5463
IV. ÇËSHTJET TREGTARE	
Kërkesë për deklarim falimentimi	26
Padi për anulim shoqërie (Neni 242)	2
Padi shlyerje dëmi të administratorit (Neni 53)	4
Padi për reklamimin e dividendëve (Neni 70)	1
Padi për përgjegjësi të Këshillit Mbikëqyrës (Neni 194)	2
Padi për tejkalim kompetence administrative (Neni 50)	0
Padi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale (Neni 103)	18
Të tjera	350
SHUMA TREGTARE	403
SHUMA A	31229
B. KËRKESA PA KUNDËRSHTARË	
I. CIVILE NË PËRGJITHËSI	
Vërtetim për vjetërsi në punë	2683
Dëshmi trashëgimie	14152
Vërtetim pronësie	2033
Urdhër ekzekutimi (si kërkesa të bëra nga personi i interesuar)	4407
Të tjera	3287
SHUMA CIVILE	26562
II. ÇËSHTJE FAMILJARE	
Kërkesë për birësim	100
Korrigjime në aktet e gjendjes civile	1051
Kërkesa për lëshim autorizimi (për të miturin)	1048
Të tjera	1867
SHUMA FAMILJARE	4066
III. ÇËSHTJE TREGTARE	
Kërkesë për emërim administratori	1
Kërkesë për ndërrimin e emrit të shoqërisë	0
Kërkesë për ndryshimin e numrit të ortakëve	0
Kërkesë për ndryshimin e kapitalit themelor	0
Kërkesë për ndryshimin e selisë së shoqërisë	0
Të tjera	30
SHUMA TREGTARE	31
SHUMA B	30659
SHUMA E PËRGJITHSHME	61888

ÇËSHTJE CIVILE GJITHSEJ ME PALË KUNDËRSHTARE


Çështjet (Cases)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2007 (Year 2007)	Përqindja (Percentage) (Year 2007)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2008 (Year 2008)	Përqindja (Percentage) (Year 2008)
Civile (Civil Cases)	14208	57%	17281	55%
Familjare (Family Cases)	6658	27%	8082	26%
Administrative (Administrative Cases)	3804	15%	5463	18
Tregtare (Commercial Cases)	356	1%	403	1%
Totali	25026	100%	31229	100%



ÇËSHJTJE CIVILE GJITHSEJ PA PALË KUNDËRSHTARE

Numri total i çështjeve pa palë kundërshtare për vitin 2007 dhe 2008 të ardhura në gjykatat e rretheve gjyqësore ka qenë si më poshtë:

Çështjet (Cases)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2007 (Year 2007)	Përqindja (Percentage) Viti 2007 (Year 2007)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2008 (Year 2008)	Përqindja (Percentage) Viti 2008 (Year 2008)
Civile	19136	79%	26562	87%
Familjare	3704	15%	4066	13%
Tregtare	1449	6%	31	0%
Totali	24289	100%	30659	100%



Numri i çështjeve të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore me palë dhe pa palë kundërshtare

- ☐ Për vitin 2006 - **59340** çështje të regjistruara
- ☐ Për vitin 2007 - **49315** çështje të regjistruara
- ☐ Për vitin 2008 - **61888** çështje të regjistruara

ÇËSHTJET CIVILE TË PËRFUNDUARA PËR VITIN 2008


(Civil Cases examined in 2008)

LLOJI I ÇËSHTJEVE (The kind of cases)	PËRFUNDUARA (Examined)
A. PADI ME PALË KUNDËRSHTARE	
I. CIVILE NË PËRGJITHËSI	
Padi pronësie (Neni 149-231)	1936
Padi uzufukti (Neni 232-260)	0
Padi servituti (Neni 261-295)	57
Padi për kërkim sendi (Neni 296-303)	896
Padi posedimore (Neni 304-315)	87
Padi trashëgimie (Neni 316-418)	165
Padi shkaktim dëmi (Neni 608-654)	953
Padi begatim pa shkak (Neni 655-658)	46
Padi pagim i padetyruar (Neni 653-654)	25
Padi gjerimi i punëve të tjetrit (Neni 648-652)	0
Padi të kontratave të shitjes (Neni 705-756)	280
Padi pjesëtim sendi (Neni 207)	473
Padi kontrate shkëmbimi (Neni 757-760)	7
Padi kontrate dhurimi (Neni 761-771)	44
Padi kontrate furnizimi (Neni 772-783)	174
Padi kontrate emfiteoze (Neni 784-800)	5
Padi kontrate qiraje (Neni 801-849)	142
Padi kontrate sipërmarrje (Neni 850-876)	169
Padi kontrate transporti (Neni 877-900)	6
Padi kontrate huapërdorje (Neni 901-912)	9
Padi kontrate të përdorjes (Neni 913-934)	9
Padi kontrate komisioni (Neni 935-944)	0
Padi kontrate spedicioni (Neni 945-949)	1
Padi kontrate agjencie (Neni 950-961)	0
Padi për kalim pasurie (Neni 962-972)	50
Padi kontrate ndërmjetësi (Neni 973-981)	0
Padi kontrate depozite (Neni 982-1012)	1
Padi kontrate llogari rrjedhëse (Neni 149-231)	0
Padi kontrate bankare (Neni 1024-1049)	2
Padi kontrate huaje (Neni 1050-1055)	536
Padi kontrate franchising (Neni 1056-1064)	0
Padi kontrate e rentës jetësore (Neni 1065-1073)	0
Padi kontrate shoqëri thjeshte (Neni 1074-1112)	2
Padi kontrate e sigurimit (Neni 1113-1161)	122
Padi të tjera kontraktuale	833
Padi kundërshtim veprimi përmbarimor	788
Padi për marrëdhënie pune	1220
Kompensim për burgim të padrejtë	71
Të tjera	3142
SHUMA CIVILE	12251

II. ÇËSHTJE FAMILJARE	
Padi për zgjidhje martese	5089
Padi për pension ushqimor	185
Padi për njohje atësie	41
Padi për ç'njohje atësie	15
Të tjera	1413
SHUMA FAMILJARE	6743
III. ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE	
Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrativ	3243
Padi për refuzim miratimi akti administrativ	322
SHUMA ADMINISTRATIVE	3565
IV. ÇËSHTJE TREGTARE	
Kërkesë për deklarim falimentimi	15
Padi për anulim shoqërie (Neni 242)	1
Padi shlyerje dëmi të administratorit (Neni 53)	2
Padi për reklamimin e dividendëve (Neni 70)	0
Padi për përgjegjësi të Këshillit Mbikëqyrës (Neni 194)	2
Padi për tejkalim kompetence administrative (Neni 50)	0
Padi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale (Neni 103)	7
Të tjera	185
SHUMA TREGTARE	212
SHUMA A	22771
B. KËRKESA PA KUNDËRSHTARË	
I. CIVILE NË PËRGJITHËSI	
Vërtetim për vjetërsi në punë	2197
Dëshmi trashëgimie	13263
Vërtetim pronësie	1423
Urdhër ekzekutimi (si kërkesa të bëra nga personi i interesuar)	4286
Të tjera	2977
SHUMA CIVILE	24146
II. ÇËSHTJE FAMILJARE	
Kërkesë për birësim	96
Korrigjime në aktet e gjendjes civile	897
Kërkesa për lëshim autorizimi (për të miturin)	1032
Të tjera	1749
SHUMA FAMILJARE	3774
III. ÇËSHTJE TREGTARE	
Kërkesë për emërim administratori	1
Kërkesë për ndërrimin e emrit të shoqërisë	0
Kërkesë për ndryshimin e numrit të ortakëve	0
Kërkesë për ndryshimin e kapitalit themelor	0
Kërkesë për ndryshimin e selisë së shoqërisë	0
Të tjera	22
SHUMA TREGTARE	23
SHUMA B	27943
SHUMA E PËRGJITHSHME	50714


ÇËSHITJE CIVILE TË PËRFUNDUARA ME PALË KUNDËRSHTARE

Çështjet (Cases)	Numri i çështjeve (Number of cases) Viti 2007 (Year 2007)	Përqindja (Percentage) Viti 2007 (Year 2007)	Numri i çështjeve (Number of cases) Viti 2008 (Year 2008)	Përqindja (Percentage) Viti 2008 (Year 2008)
Civile (Civil Cases)	10359	55%	12251	54%
Familjare (Family Cases)	5643	30%	6743	29%
Administrative (Administrative Cases)	2667	14%	3565	16%
Tregtare (Commercial Cases)	256	1%	212	1%
Totali	18925	100%	22771	100%



ÇËSHTJE CIVILE TË PËRFUNDUARA PA PALË KUNDËRSHTARE

Çështjet (Cases)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2007 (Year 2007)	Përqindja (Percentage) Viti 2007 (Year 2007)	Numri i çështjeve (Number of Cases) Viti 2008 (Year 2008)	Përqindja (Percentage) Viti 2008 (Year 2008)
Civile (Civil Cases)	17951	78%	24146	86%
Familjare (Family Cases)	3520	16%	3774	14%
Tregtare (Commercial Cases)	1422	6%	23	0%
Totali	22893	100%	27943	100%



Numri total i çështjeve të përfunduara me palë dhe pa palë kundërshtare është:

- ☐ Për vitin 2006 - **52985** (çështje të shqyrtuara)
- ☐ Për vitin 2007 - **41818** (çështje të shqyrtuara)
- ☐ Për vitin 2008- **50714** (çështje të shqyrtuara)

ANALIZË STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE TË PËRFUNDUARA CIVILE NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË PËR 3 VITET E FUNDIT (Analysis of Civil Cases examined by District Courts in the last 3 years)

Në vitin 2004 shuma e përgjithshme e çështjeve civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë arrin në shifrën 41755. Këtu përfshihen çështje civile të shqyrtuara, paditë e të cilave janë me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare. Konkretisht për vitin 2004 padi civile të shqyrtuara me palë kundërshtare janë 13445, ndërsa paditë civile të shqyrtuara pa palë kundërshtare janë 28310.

Në vitin 2005 shuma e përgjithshme e padive civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë është 51353. Padi civile të shqyrtuara me palë kundërshtare janë 15781, ndërkohë që numri i padive civile të shqyrtuara pa palë kundërshtare arrin në 35572. Krahasuar me vitin 2004, në vitin 2005 janë shqyrtuar 9618 padi civile më shumë se sa në vitin 2004.

Për vitin 2006 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 52985. Nga këto padi civile, ato të cilat janë me palë kundërshtare janë 17563, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë janë rreth 35422, kjo do të thotë që në vitin 2006 nga gjykatat e shkallës së parë janë gjykuar 1631 padi civile më shumë krahasuar me paditë civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë në vitin 2005, si edhe 11230 padi civile më shumë krahasuar me numrin e padive civile të shqyrtuara në vitin 2004.

Për vitin 2007 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 41818. Nga këto padi civile ato të cilat janë me palë kundërshtare janë 18925, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë janë rreth 22893. Në vitin 2007 nga gjykatat e shkallës së parë janë gjykuar 1362 padi civile me palë më shumë krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë në vitin 2006, si edhe 3144 padi civile më shumë krahasuar me numrin e padive civile me palë të shqyrtuara në vitin 2005.

Për vitin 2008 numri i padive civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 50714. Nga këto padi civile ato të cilat janë me palë kundërshtare janë 22771, ndërsa paditë civile pa palë kundërshtare të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë janë rreth 27943. Në vitin 2008 nga gjykatat e shkallës së parë janë gjykuar 3846 padi civile me palë më shumë krahasuar me paditë civile me palë të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë në vitin 2007, si edhe 5208 padi civile më shumë krahasuar me numrin e padive civile me palë të shqyrtuara në vitin 2006. Duke krahasuar numrin e padive me palë kundërshtare për vitin 2005 është 6990 më shumë se sa për vitin 2008.

ANALIZË KRAHASUESE E PADIVE CIVILE TË VEÇANTA PËR KATËR VITET E FUNDIT

Duke u nisur nga rëndësia e marrëdhënieve juridike civile, të cilat rregullohen nga dispozitat e së drejtës civile, ka disa padi për të cilat paditësi vë në lëvizje më shpesh gjykatën për të vendosur në vend interesin e tij të shkelur nga i padituri nëpërmjet organeve gjyqësore. Të tilla janë paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e pronësisë (**Nenet 149-231 KC**), paditë për kërkimin e sendit (**Nenet 296-303 KC**), paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, paditë në të cilat kërkohet kundërshtimi i veprimit përmbarimor, si edhe çështjet civile me karakter administrativ. Më poshtë po japim situatën se si ka ndryshuar numri i këtyre padive të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë në pesë vitet e fundit pra në vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2008.

Paditë e pronësisë (Nenet 149-231 KC)

Për vetë rëndësinë që mbartin, është e nevojshme të analizohet ecuria e numrit të padive të pronësisë (149-231 KC) të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë në këto katër vitet e fundit. Konstatohet që numri i konflikteve për çështjet e pronësisë përbën volumnin më të madh të padive të paraqitura në gjykatë për shqyrtim nga palët paditëse.

Konkretisht për **vitin 2004** shënohen gjithsej rreth 1502 padi civile, me objekt çështjet e pronësisë të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë.

Në vitin 2005 shifra e padive të pronësisë të shqyrtuara nga këto gjykata arrin në 1739, që do të thotë 237 padi civile pronësie të shqyrtuara më shumë se sa në vitin 2004.

Në vitin 2006 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 1563 duke u përafëruar me numrin e padive të pronësisë të shqyrtuara në vitin 2004, i cili sikurse u tregua më lart ishte rreth 1502. Në vitin 2006 numri i padive të pronësisë lëviz me 61 çështje më shumë se në vitin 2004, si edhe me 176 padi pronësie të shqyrtuara më pak se në vitin 2005. Sikurse shihet numri më i madh i padive të pronësisë të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë është në vitin 2005.

Në vitin 2007 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 1751. Në vitin 2007 numri i padive të pronësisë është 249 çështje më shumë se në vitin 2004. Në vitin 2007 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është pothuajse i njëjtë me vitin 2005. Në vitin 2007 nga gjykatat e shkallës së parë janë shqyrtuar 188 padi pronësie më shumë në krahasim me vitin 2006.

Në vitin 2008 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 1936. Në vitin 2008 numri i padive të pronësisë është 434 çështje më shumë se në vitin 2004. Në vitin 2008 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 197 çështje më shumë se në vitin 2005. Në vitin 2008 nga gjykatat e shkallës së parë janë shqyrtuar 373 padi pronësie më shumë në krahasim me vitin 2006 dhe në krahasim me vitin 2007 numri i padive të pronësisë të shqyrtuara është 185 çështje më shumë për 2008.

Padia për kërkimin e sendit (296-303 KC)

Pas padive të pronësisë numrin më të madh të padive civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë e përbëjnë paditë për kërkimin e sendit.

Në vitin 2004 gjykatat e shkallës së parë kanë shqyrtuar një numër prej 604 padish civile për kërkimin e sendit.

Në vitin 2005 ky numër arrin në 780 pra 176 më shumë se numri i padive të shqyrtuara në vitin 2004 nga gjykatat e shkallës së parë.

Në vitin 2006 numri i padive civile për kërkimin e sendit të shqyrtuara është 775, pra 3 padi më pak se numri i padive të shqyrtuara në 2005. Normalisht mund të themi se numri i padive civile për kërkimin e sendit ndërmjet viteve 2005 dhe 2006 është pothuaj i njëjtë. Pra numri më i vogël i padive për kërkimin e sendit është shqyrtuar në vitin 2004 nga gjykatat e shkallës së parë.

Në vitin 2007 numri i padive civile për kërkimin e sendit të shqyrtuara është 861, pra 86 padi më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2006. Normalisht mund të themi se numri i padive civile për kërkimin e sendit ndërmjet viteve 2005 dhe 2006 është pothuaj i njëjtë. Pra numri më i vogël i padive për kërkimin e sendit është shqyrtuar në vitin 2004 nga gjykatat e shkallës së parë.

Në vitin 2008 numri i padive civile për kërkimin e sendit të shqyrtuara është 896, pra 35 padi më shumë se numri i padive të shqyrtuara në 2007. Duke krahasuar vitin 2008 me vitin 2004 vëhet re se numrin e padive civile të shqyrtuara për këtë vit është rritur me 292 padi më shumë dhe në krahasim me vitin 2005 vëhet re se numri i padive civile të shqyrtuara për këtë vit është rritur me 116 padi më shumë, ndërsa për vitin 2006 vëhet re një rritje relativisht e vogël me 121 padi të shqyrtuara më shumë.

Duke bërë krahasimet midis viteve 2004 deri në 2008 mund të themi se ka një zvogëlim gradual të padive të shqyrtuara për kërkimin e sendit, por gjithsesi këto lloj padish zënë një numër të konsiderueshëm në paditë e shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë.

Padi për marrëdhënie pune

Një numër i konsiderueshëm padish, të cilat janë paraqitur për t'u shqyrtuar nga gjykatat e shkallës së parë, janë edhe paditë objekt i të cilave janë marrëdhëniet juridike ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në vitin 2004 janë shqyrtuar gjithsej 672 padi për marrëdhëniet e punës.

Në vitin 2005 kjo shifër ulet në 635, pra me 37 çështje më pak të shqyrtuara se në vitin 2004.

Numri i padive në objektin e të cilave janë marrëdhëniet e punës ngrihet ndjeshëm në **vitin 2006**, duke arritur në 1680 padi të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë. Konkretisht në vitin 2006 janë shqyrtuar 1008 padi për marrëdhënie pune më shumë se në vitin 2004 dhe 1045 padi të tilla më shumë se në vitin 2005.

Në vitin 2007 numri i padive të shqyrtuara në objektin e të cilave janë marrëdhëniet e punës është në **1498**, pra **182** padi më pak se një vit më parë.

Në vitin 2008 numri i padive për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara është 1220. Duke krahasuar me vitin 2007 rezultojnë 278 më pak padi të shqyrtuara se në vitin 2007 dhe 460 padi më pak se për vitin 2006. Vihet re se nga dy vitet e fundit paditë për marrëdhëniet e punës të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë janë zvogëluar ndjeshëm.

Padi kundërshtim veprimi përmbarimor

Në vitin 2004 numri i padive me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë është 408.

Në vitin 2005 numri i këtyre padive të shqyrtuara ngrihet me 64 çështje më shumë, duke arritur në 472 padi kundërshtimi veprimi përmbarimor të shqyrtuara.

Numri më i madh i padive të shqyrtuara, objekt i të cilave është kundërshtimi veprimi përmbarimor është në **vitin 2006**, në të cilin janë shqyrtuar 655 padi të tilla nga gjykatat e shkallës së parë që do të thotë se në vitin 2006 janë shqyrtuar 247 padi të tilla më shumë se në vitin 2004 dhe 183 padi të tilla më shumë se në vitin 2005.

Në vitin 2007 numri i këtyre padive të shqyrtuara ulet me 61 çështje më pak, duke arritur në 594 padi kundërshtimi veprimi përmbarimor të shqyrtuara.

Në vitin 2008 numri i këtyre padive të shqyrtuara rritet me 194 çështje më shumë sesa për vitin 2007 duke arritur në 788 padi kundërshtimi veprimi përmbarimor të shqyrtuara për këtë vit.

Çështje tregtare

Për vitin 2008 është e rëndësishme të theksohet se me ardhjen në fuqi të ligjit të ri për shoqëritë tregtare, gjykatat e shkallës së parë nuk kanë shqyrtuar më çështje pa palë kundërshtare, kompetencë kjo tashmë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si pasojë numri i këtyre çështjeve është reduktuar në shifra minimale. Përsa i përket kësaj analize ne do të shprehemi vetëm për vitin 2008.

Konkretisht për vitin **2008** nga gjykatat e shkallës së parë është shqyrtuar gjithsej 1 kërkesë tregtare pa palë kundërshtare, e cila ka për objekt kërkesën për emërimin e administratorit .

ÇËSHTJET CIVILE (ADMINISTRATIVE ME PALË) TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2008 SIPAS GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Pa përfunduar (Pending)
Berat	70	61	9
Dibër	89	63	26
Durrës	156	104	52
Elbasan	186	137	49
Fier	103	72	31
Gjirokastrë	139	111	28
Kavajë	20	8	12
Korçë	432	271	161
Krujë	42	25	17
Kukës	83	50	33
Kurbin	0	0	0
Lezhë	228	204	24
Lushnjë	94	71	23
Mat	26	19	7
Pogradec	18	13	5
Pukë	5	5	0
Sarandë	200	155	45
Shkodër	425	364	61
Tiranë	2652	1467	1185
Tropojë	82	74	8
Vlorë	413	291	122
T O T A L I	5463	3565	1898


ÇËSHTJE CIVILE (ADMINISTRATIVE ME PALË) GJITHSEJ TË GJYKUARA PËR VITIN 2008

Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Përfunduar
(District courts)	(Examined)
Berat	61
Dibër	63
Durrës	104
Elbasan	137
Fier	72
Gjirokastrë	111
Kavajë	8
Korçë	271
Krujë	25
Kukës	50
Kurbin	0
Lezhë	204
Lushnjë	71
Mat	19
Pogradec	13
Pukë	5
Sarandë	155
Shkodër	364
Tiranë	1467
Tropojë	74
Vlorë	291
T O T A L I	3565

Për vitin 2008 janë gjykuar gjithsej 3565 çështje administrative nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

ÇËSHTJET CIVILE (ADMINISTRATIVE ME PALË) TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2006, 2007 DHE 2008

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2006	2160	1680	480
Viti 2007	3804	2667	1137
Viti 2008	5463	3565	1898



ÇËSHTJET CIVILE ME OBJEKT MARRËDHËNIET E PUNËS TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2008


Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Berat	57	43	14
Dibër	40	31	9
Durrës	47	34	13
Elbasan	185	129	56
Fier	80	68	12
Gjirokastrë	57	45	12
Kavajë	12	10	2
Korçë	123	110	13
Krujë	23	17	6
Kukës	26	25	1
Kurbin	27	14	13
Lezhë	41	37	4
Lushnjë	37	30	7
Mat	16	12	4
Pogradec	74	66	8
Pukë	18	17	1
Sarandë	5	5	0
Shkodër	56	50	6
Tiranë	629	372	257
Tropojë	9	9	0
Vlorë	117	96	21
T O T A L I	1679	1220	459

ÇËSHTJET CIVILE, OBJEKTI I TË CILAVE JANË MARRËDHENIET E PUNËS,
TË SHQYRTUARA PËR VITIN 2008 SIPAS GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District courts)	Përfunduar (Examined)
Berat	43
Dibër	31
Durrës	34
Elbasan	129
Fier	68
Gjirokastrë	45
Kavajë	10
Korçë	110
Krujë	17
Kukës	25
Kurbin	14
Lezhë	37
Lushnjë	30
Mat	12
Pogradec	66
Pukë	17
Sarandë	5
Shkodër	50
Tiranë	372
Tropojë	9
Vlorë	96
T O T A L I	1220

ÇËSHTJET CIVILE OBJEKTI I TË CILAVE JANË MARRËDHENIET E PUNËS TË SHQYRTUARA PËR VITET 2006, 2007 DHE 2008

Periudha kohore	Gjithsej për gjykim (Total)	Përfunduar (Examined)	Papërfunduar (Pending)
Viti 2006	2160	1680	480
Viti 2007	1835	1498	337
Viti 2008	1679	1220	459



DINAMIKA E ÇËSHTJEVE CIVILE SIPAS RRETHEVE PËR VITIN 2008 (Dynamics of Civil Cases for 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Mbartur (Old cases)	Të ardhura të reja (New cases)	Ardhur pas prishjes (Came after reversed)	SHUMA (Total)
Berat	174	2206	6	2386
Dibër	91	873	11	975
Durrës	597	4739	21	5357
Elbasan	537	3461	14	4012
Fier	294	2559	20	2873
Gjirokastrë	421	2607	127	3155
Kavajë	140	1104	5	1249
Korçë	334	4348	8	4690
Krujë	198	959	13	1170
Kukës	82	690	3	775
Kurbin	121	1139	23	1283
Lezhë	174	2200	2	2376
Lushnjë	232	1433	4	1669
Mat	58	758	3	819
Pogradec	260	1615	7	1882
Pukë	48	487	4	539
Sarandë	256	1722	19	1997
Shkodër	271	3949	54	4274
Tiranë	2701	12901	347	15949
Tropojë	19	305	2	326
Vlorë	487	3610	35	4132
T O T A L I	7495	53665	728	61888

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE CIVILE (Way of termination for Civil Cases)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Pranuar (Accepted)	Zgjidhje me pajtim (Resolve with agreement)	Refuzuar (Refused)	Pushuar (Ceased)	Total Të përfunduara (Total Examined)
Berat	1517	9	181	440	2147
Dibër	519	1	68	254	842
Durrës	3300	8	94	1066	4468
Elbasan	1999	15	141	1016	3171
Fier	2057	2	111	488	2658
Gjirokastrë	2065	2	168	556	2791
Kavajë	764	0	58	233	1055
Korçë	2869	6	236	901	4012
Krujë	701	7	28	233	969
Kukës	426	1	28	230	685
Kurbin	749	1	70	290	1110
Lezhë	1603	8	116	453	2180
Lushnjë	991	9	78	365	1443
Mat	548	1	26	162	737
Pogradec	1156	2	109	318	1585
Pukë	290	4	49	102	445
Sarandë	1288	4	103	283	1678
Shkodër	2880	2	186	868	3936
Tiranë	5678	14	710	4776	11178
Tropojë	164	6	24	83	277
Vlorë	2165	15	200	967	3347
T O T A L I	33729	117	2784	14084	50714

ÇËSHTJET CIVILE SIPAS RRETHEVE PËR VITIN 2008
(Civil Cases according to District's Courts for 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Përfunduar (Examined)	Pa përfunduar (Pending)	Gjithsej (Total)
Berat	2147	239	2386
Dibër	842	133	975
Durrës	4468	889	5357
Elbasan	3171	841	4012
Fier	2658	215	2873
Gjirokastrë	2791	364	3155
Kavajë	1055	194	1249
Korçë	4012	678	4690
Krujë	969	201	1170
Kukës	685	90	775
Kurbin	1110	173	1283
Lezhë	2180	196	2376
Lushnjë	1443	226	1669
Mat	737	82	819
Pogradec	1585	297	1882
Pukë	445	94	539
Sarandë	1678	319	1997
Shkodër	3936	338	4274
Tiranë	11178	4771	15949
Tropojë	277	49	326
Vlorë	3347	785	4132
T O T A L I	50714	11174	61888


AFATET E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE CIVILE (Time of termination for civil cases)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Afati i përfundimit (Term of termination)		
	0-2 muaj (0-2 months)	2-6 muaj (2-6 months)	Mbi 6 muaj (Over 6 months)
Berat	1784	327	36
Dibër	686	141	15
Durrës	3473	743	252
Elbasan	1989	967	215
Fier	1018	938	702
Gjirokastrë	2275	468	48
Kavajë	716	187	152
Korçë	3492	444	76
Krujë	682	217	70
Kukës	563	122	0
Kurbin	973	128	9
Lezhë	1647	454	79
Lushnjë	1101	268	74
Mat	643	73	21
Pogradec	1175	343	67
Pukë	262	183	0
Sarandë	1123	498	57
Shkodër	2321	855	760
Tiranë	1960	3373	5845
Tropojë	213	56	8
Vlorë	538	1216	1593
T O T A L I	28634	12001	10079

**ÇËSHTJE CIVILE TË PËRFUNDUARA SIPAS RRETHEVE TË SHPREHUARA NË
PËRQINDJE**
(Terminated civil cases from District's Courts)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Përfunduar (Terminated)	Përqindja (Percentage) (%)
Berat	2147	4%
Dibër	842	1%
Durrës	4468	9%
Elbasan	3171	6%
Fier	2658	5%
Gjirokastrë	2791	5%
Kavajë	1055	2%
Korçë	4012	7%
Krujë	969	2%
Kukës	685	1%
Kurbin	1110	2%
Lezhë	2180	4%
Lushnjë	1443	3%
Mat	737	1%
Pogradec	1585	3%
Pukë	445	1%
Sarandë	1678	3%
Shkodër	3936	7%
Tiranë	11178	26%
Tropojë	277	1%
Vlorë	3347	7%
T O T A L I	50714	100%

Numri i çështjeve civile të përfunduara sipas rretheve



ÇËSHITJE TË ANKIMUARA SIPAS GJYKATAVE (Appealed cases according to District's Courts)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Çështje të ankimuara (Appealed cases)
Berat	163
Dibër	93
Durrës	398
Elbasan	357
Fier	226
Gjirokastrë	247
Kavajë	39
Korçë	371
Krujë	84
Kukës	71
Kurbin	88
Lezhë	173
Lushnjë	103
Mat	67
Pogradec	126
Pukë	32
Sarandë	152
Shkodër	375
Tiranë	1672
Tropojë	88
Vlorë	92
TOTALI	5017

VOLUMI I PUNËS PËR GJASHTË VITET E FUNDIT PËR ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË (Workload of District's Courts for completed Civil Cases of the last six years)

Në lidhje me numrin e çështjeve civile të përfunduara nga gjykatat e shkallës së parë do të analizohet krahasimisht se si ka qenë situata lidhur me volumin e punës në gjashtë vitet e fundit.

Në vitin 2003 numri i çështjeve civile të përfunduara së shqyrtuari nga gjykatat e shkallës së parë është rreth 40197.

Në vitin 2004 ky numër çështjesh civile ngrihet në rreth 41755. Kjo do të thotë se në vitin 2004 janë shqyrtuar 1558 çështje civile më shumë se sa në vitin 2003.

Në vitin 2005 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 51355 pra do të thotë një rritje prej rreth 9600 çështjesh civile të shqyrtuara më shumë se në vitin 2004 dhe 11158 çështje civile më shumë se në vitin 2003.


Në vitin 2006 numri i çështjeve civile të përfunduara të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë vazhdon të pësojë rritje edhe kështu në këtë vit numërohen 52985 çështje civile të shqyrtuara nga këto gjykata, që do të thotë se në vitin 2006 janë shqyrtuar 1630 çështje civile më shumë se në vitin 2005, 11230 çështje civile më shumë të shqyrtuara se në vitin 2004 dhe 12788 çështje civile më shumë se në vitin 2003.

Në vitin 2007 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 41818 pra do të thotë ulje prej 11167 çështjeve civile më pak se në vitin 2006, një ulje prej rreth 9545 çështjesh civile të shqyrtuara më pak se në vitin 2005, numër përafërsisht i njëjtë me vitin 2004 dhe 1621 çështje civile më shumë se në vitin 2003.

Në vitin 2008 numri i çështjeve civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë arrin në 50714 duke pësuar një rritje prej 8896 çështjesh krahasuar me vitin 2007, ulje prej 2271 çështjesh krahasuar me vitin 2006 dhe një ulje prej 649 çështjesh në krahasim me vitin 2005.

Duke u nisur nga statistikatat e mësipërme arrihet në konkluzionin se volumi i punës për çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë për vitin 2008, ndonëse më i ulët se ai i viteve 2005 dhe 2006, ka pësuar rritje në krahasim me vitin paraardhës.

Çështjet civile (Civil Cases)	Viti (Year) 2003	Viti (Year) 2004	Viti (Year) 2005	Viti (Year) 2006	Viti (Year) 2007	Viti Year 2008
Të përfunduara (Terminated Cases)	40197	41755	51363	52985	41818	50714



ZGJIDHJET E MARTESES (The Divorces)

Në rubrikën e çështjeve familjare, analiza statistikore, për efekt të rëndësisë, do të fokusohet kryesisht në krahasimin e zgjidhjeve të martesës në pesë vitet e fundit.

Në vitin 2004 janë regjistruar gjithsej **4577** çështje familjare në gjykatat e shkallës së parë. Nga totali i këtyre çështjeve familjare **3670** kanë qenë zgjidhje martese.

Në vitin 2005 janë regjistruar gjithsej **5526** çështje familjare, nga të cilat **4633** kanë qenë zgjidhje martese, pra në vitin 2005 janë shqyrtuar 963 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2004.

Në vitin 2006 numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **5742**. Nga ky numër **4727** janë zgjidhje martese, pra 94 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2005 dhe 1057 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2004.


Në vitin 2007 numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **6658**. Nga ky numër **5335** janë zgjidhje martese, pra 808 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2006 dhe 902 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2005.

Në vitin 2008 numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **8082**. Nga ky numër **6109** janë zgjidhje martese, pra 774 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2007 dhe 1382 zgjidhje martese më shumë se sa në vitin 2006.

Nga **6109** çështjet e regjistruara, **5089** kanë përfunduar dhe **1020** janë ende pa përfunduar. Nga çështjet e përfunduara **2122** janë me kërkesën e bashkëshortit, **3155** me kërkesën e bashkëshortes dhe **832** me kërkesë të përbashkët.

Si konkluzion mund të thuhet që numri i zgjidhjeve të martesës të shqyrtuara nga gjykatat ka ardhur në rritje në krahasim me vitet e mëparshme.

Çështjet familjare (Family Cases)	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008
Zgjidhjet e martesës	3670	4633	4727	5335	6109



ZGJIDHJET E MARTESES SIPAS RRETHEVE PËR VITIN 2008
(The divorces according to district's courts in 2008)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's court)	Mbartur (Old cases)	Të ardhura të reja (New cases)	Ardhur pas prishjes (Came after reversed)	SHUMA (Total)	Përfunduar (Terminated)	Pa përfunduar (Pending)
Berat	41	291	0	332	282	50
Dibër	14	99	0	113	97	16
Durrës	67	473	0	540	468	72
Elbasan	60	490	0	550	469	81
Fier	78	366	0	444	407	37
Gjirokastrë	38	210	0	248	218	30
Kavajë	20	117	0	137	107	30
Korçë	23	370	0	393	325	68
Krujë	11	55	0	66	53	13
Kukës	9	57	1	67	60	7
Kurbin	9	88	0	97	83	14
Lezhë	22	161	0	183	161	22
Lushnjë	30	184	0	214	188	26
Mat	6	54	0	60	50	10
Pogradec	21	110	0	131	106	25
Pukë	5	21	0	26	25	1
Sarandë	29	169	1	199	178	21
Shkodër	38	327	3	368	340	28
Tiranë	274	1161	15	1450	1091	359
Tropojë	4	25	0	29	23	6
Vlorë	56	405	1	462	358	104
T O T A L I	855	5233	21	6109	5089	1020

KREU X

❖ ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE

(Civil Appeals examined by Appeal Courts)

ANALIZË STATISTIKORE KRAHASUESE PËR ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE (Comparative analysis for Civil Appeals examined by Courts of Appeal)

Në vitin 2004 nga gjykatat e apeleve të rretheve Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë janë shqyrtuar **3384** çështje civile.

Në vitin 2005 nga gjykatat e apeleve janë shqyrtuar **3797** çështje civile ose **413** çështje civile më shumë se viti 2004.

Për vitin 2006 çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve janë **3577**. Pra krahasuar me çështjet civile të shqyrtuara në vitet 2004 dhe 2005, janë konkretisht **220 çështje civile të shqyrtuara më pak se në vitin 2005 dhe 193 çështje civile më shumë se në vitin 2004**.

Për vitin 2007 çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve janë **4412**. Pra krahasuar me çështjet civile të shqyrtuara në vitet 2004, 2005 dhe 2006, janë konkretisht **835 çështje civile të shqyrtuara më shumë se në vitin 2006, 615 çështje civile më shumë se në vitin 2005 dhe 1028 çështje civile më shumë se në vitin 2004**.

Për vitin 2008 çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e apeleve janë **4370**. Pra krahasuar me çështjet civile të shqyrtuara në vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, janë konkretisht **42 çështje civile të shqyrtuara më pak se në vitin 2007, 793 çështje civile më shumë se në vitin 2006, 573 çështje civile të shqyrtuara më shumë se në vitin 2005 dhe 986 çështje civile më shumë se në vitin 2004**.

Për lehtësi do të analizojmë krahasimisht secilën gjykatë apeli, duke dhënë numrin e çështjeve të shqyrtuara të shprehura edhe në përqindje për pesë vitet 2004, 2005 2006, 2007 dhe 2008.

□ Gjykata e Apelit Durrës

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **603** çështje civile ose **18 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ulet në **568** ose **15%** të **3797** çështjeve civile të shqyrtuara në total.

Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Durrës ka shqyrtuar **606** çështje civile ose **17 %** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Durrës ka shqyrtuar **567** çështje civile ose **13 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Durrës ka shqyrtuar **527** çështje civile ose **12 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.

□ Gjykata e Apelit Gjirokastrë

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **470** çështje civile ose **14 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ulet në **397** ose **10%** të **3797** të çështjeve civile të shqyrtuara në total.

Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar **448** çështje civile ose **13%** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar **457** çështje civile ose **10 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar **497** çështje civile ose **11 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.

□ Gjykata e Apelit Korçë

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **318** çështje civile ose **9 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ulet në **308** ose **8 %** të **3797** të çështjeve civile të shqyrtuara në total.

Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Korçë ka shqyrtuar **309** çështje civile ose **9 %** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Korçë ka shqyrtuar **424** çështje civile ose **10 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Korçë ka shqyrtuar **378** çështje civile ose **9 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.

□ Gjykata e Apelit Shkodër

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **318** çështje civile ose **9 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ngrihet në **541** ose **14%** të **3797** të çështjeve civile të shqyrtuara në total.

Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Shkodër ka shqyrtuar **453** çështje civile ose **13 %** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Shkodër ka shqyrtuar **590** çështje civile ose **13 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Shkodër ka shqyrtuar **575** çështje civile ose **13 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.

□ Gjykata e Apelit Tiranë

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **1308** çështje civile ose **39 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ulet në **1279** ose **34%** të **3797** të çështjeve civile të shqyrtuara në total.

Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar **1062** çështje civile ose **29 %** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar **1649** çështje civile ose **37 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar **2037** çështje civile ose **47 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.

□ Gjykata e Apelit Vlorë

Në vitin 2004 nga kjo gjykatë janë shqyrtuar **367** çështje civile ose **11 %** të **3384** çështjeve të shqyrtuara në total.

Në vitin 2005 kjo shifër çështjesh civile të shqyrtuara ngrihet në **704** ose **19%** të **3797** të çështjeve civile të shqyrtuara në total.


Në vitin 2006 Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar **699** çështje civile ose **19 %** të totalit prej **3577** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2007 Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar **725** çështje civile ose **16 %** të totalit prej **4412** çështjesh civile të shqyrtuara.

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar **356** çështje civile ose **8 %** të totalit prej **4370** çështjesh civile të shqyrtuara.


ÇËSHTJE CIVILE TË PËRFUNDUARA NGA GJYKATAT E APELEVE (Civil Appeals Terminated by Courts of Appeal)

Çështjet civile të përfunduara (Terminated cases)	Viti (Year) 2004	Viti (Year) 2005	Viti (Year) 2006	Viti (Year) 2007	Viti (Year) 2008
Apelet (Appeals)	3384	3797	3557	4412	4370



ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE VITI 2008 (Civil Appeal examined by Courts of Appeal 2008)

Gjykatat e apeleve (Courts of Appeal)	Çështje të shqyrtuara (Examined Cases)	Përqindja (Percentage)
DURRËS	527	12%
GJIROKASTËR	497	11%
KORÇË	378	9%
SHKODËR	575	13%
TIRANË	2037	47%
VLORE	356	8%
TOTALI	4370	100%



ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELEVE (Civil Appeals examined by Courts of Appeal)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Çështje të përfunduara (Examined)	Lënë në fuqi (Allowed)	%	Ndryshuar (Changed)	%
Berat	53	39	74	3	6
Bulqizë	17	7	41	4	23
Dibër	81	61	75	9	11
Durrës	240	180	75	0	0
Elbasan	180	128	71	0	0
Fier	128	88	69	14	11
Gjirokastrë	217	173	80	26	12
Gramsh	23	16	70	0	0
Kavajë	51	33	65	0	0
Korçë	290	222	76	32	10
Krujë	58	30	52	2	3
Kukës	60	31	52	7	12
Kurbin	57	34	60	8	14
Lezhë	128	61	48	21	16
Librazhd	33	27	82	0	0
Lushnjë	42	28	67	7	17
Mat	80	48	60	3	4
Mirditë	38	19	50	12	32
Përmet	5	4	80	1	20
Pogradec	88	71	81	10	11
Puka	27	15	55	4	15
Sarandë	263	215	82	33	12
Shkodër	344	175	51	69	20
Skrapar	10	5	50	1	10
Tepelenë	12	8	67	4	33
Tiranë	1706	1187	70	209	12
Tropojë	16	12	75	0	0
Vlorë	123	78	61	10	8
T O T A L I	4370	2995	68	489	11

VËSHTRIM I CILËSISË SË GJYKIMIT PËR ÇËSHTJET CIVILE TË SHQYRTUARA NË PERIUHDHËN E PESË VITEVE TË FUNDIT

Viti 2008

Për vitin 2008, në lidhje me cilësinë e gjykimit të çështjeve civile, nga statistikatat rezultojnë se gjykatat e apelit në shkallë republike kanë përfunduar së shqyrtuari **4370** vendime gjyqësore për çështjet civile të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë, vendimi i të cilave është apeluar në gjykatat e apelit. Gjykatat përkatëse të apelit kanë vendosur lënien në fuqi të **2995** çështjeve civile e interpretuar në përqindje është **68%** të vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë të rretheve gjyqësore në shkallë vendi.

Në mënyrë tabelare më poshtë do t'u referohemi në total çështjeve të shqyrtuara sipas gjykatave të apeleve përkatëse, shprehur në vendime të lëna në fuqi dhe vendime të ndryshuara në shifra dhe përqindje, pra për vitin 2008 kemi:

Gjykata e Apelit Durrës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's Court)	Çështje të përfunduara (Examined)	Lënë në fuqi (Allowed)	%	Ndryshuar (Changed)	%
Durrës	240	180	75	-	0
Elbasan	180	128	71	-	0
Kavajë	51	33	65	-	0
Librazhd	33	27	82	-	0
Gramsh	23	16	70	-	0
Totali	527	384	73	0	0

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi mesatarisht **73%** dhe ka ndryshuar **0%** të vendimeve të gjykatave të shkallës së parë të paraqitura në tabelë. Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi 75% të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, po ashtu kjo Gjykatë ka lënë në fuqi 71% të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, 65% të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, 82% e vendimeve janë lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe 70% e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh janë lënë në fuqi.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District's Court)	Çështje të përfunduara (Examined)	Lënë në fuqi (Confirmed)	%	Ndryshuar (Changed)	%
Gjirokastrë	217	173	80	26	12
Përmet	5	4	80	1	20
Sarandë	263	215	82	33	12
Tepelenë	12	8	67	4	33
Totali	497	400	80	64	13

Në vitin 2008 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka lënë në fuqi mesatarisht **80%** dhe ka ndryshuar **13%** të gjykatave të shkallës së parë të paraqitura në tabelë.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka lënë në fuqi 80% të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, po ashtu kjo Gjykatë ka lënë në fuqi 80% të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, 82% të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe 67% të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë janë lënë në fuqi.

Gjykata e Apelit Korçë

